

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.12.2024, ora 10:20 në ambjentet e qëndrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Kruetari I Bashkisë Elbasan Z.Gledian Llatja Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Mirëseerdhët në mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak. Ftoj sekretarin të bëj apelin.

Sekretari i këshillit bashkiak bën apelin. Marrin pjesë 41 anëtarë të Këshillit Bashkiak.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Fillojmë me miratim e rendit të ditës. Të gjithë e keni rendin para një gjithsej 27 pika. Hiqet pika 6 Për miratimin e planit vendor të mjedisit për vitin 2025-2026 dhe tek të ndryshmet shtohet pika e marrveshjes me bashkinë Elbasan dhe një pikë mbi shtesën e fondit grand. Materialit I keni në dosje. Flisni me radhë për procedurë vetëm kryetarët e grupeve.

### **Doris Madhi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Na keni shtuar para 2 ditësh pika që lidhen me qytetar nderi nga 18 deri tek 26 pa marrë në konsiderat komisionet dhe kryesinë jemi në mbledhjen më të rëndësishme të vitit që duhet ti ishte dedikuar vetëm buxhetit hiq ndihmën ekonomike që është dicka urgjente dhe që duhet të futet un mendoj që ka kohë për ti dhënë kto tituj aq më tepër që jeni në shkelje të rregullores nuk I keni sjell material brënda afatit 5 ditor sipas rregullores që është përcaktur. Keni bërë të njëjtën gjë dhe me pikat e tjera sepse në koferencën e kryetarëve është thënë që do të kishim një rend dite me dhjetë pika dhe I fundit do të ishte buxheti, nga pika 11 e keni lëvizur buxhetin tek pika 13 por nga pika 11 deri tek pika 18 ku jemi I keni shtuara në mënyrë arbitrare jeni në shkelje të rregullores. Sugjeroj që kto të hiqen dhe të merremi me ato që jemi për tu marrë, duhet të merremi me buxhetin është mbledhja më e rëndësishme e vitit

### **Altin Mecja-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ktë do të thoja dhe unë që janë shumë pika dhe që duhen diskutuar shumë materiale na kanë ardhur dje. Pika shtatë për propozimin dhe bashkëpunimin midis bashkisë Elbasan dhe komunës Preshevë, serbi duhet formuluar më mirë të paktën, nuk e di kush e konceptuar këtë

### **Blendi Himci-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Të jemi pak më rracional në këtë histori, përse I përket grandit që vjen nga qeveria unë jam dakord që parimisht të kalojë këtë e flas dhe në emër të grupit për arsye sepse flitet për një investim që është në të mirë të qytetit. Por përse I përket pjesës së dhënieve të titujve qytetar nderi nuk është dhe aq urgjente për tu futurë në këshill apo marrveshja me akademin e shkencave dhe të vendosi këshilli bashkiak një datë që ti diskutojmë me qetsi. Ne nuk mund të bëjmë inflacion të pikave të rendit të ditës. Sot jemi dhe jemi përgatit për sa I përket aktir më të rëndësishëm të qytetit tonë që është buxheti I Bashkisë për vitin 2025. të arsyetojmë pak mos e kthejmë që tani situatën konfuzionale për tu përdorur forca e kartonit. Mendoj të përdoret arsyetimi dhe llogjika në këtë mbledhje kaq të rëndësishme që është pikërisht buxheti.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Lidhur me kto pikat duke qënë që janë rreth 7 pika për qytetar nderi.

### **Enerieta Ferra -Zv Kryetare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Unë mendoj që nuk ka asnjë problem sepse ato qytetarët e nderit janë 7, ndihma ekonomike kalon, janë disa pika që sjanë shumë të rëndësishme që kalojnë lehtësisht skemi pse të mblidhemi përsëri unë mendoj që kto duhet të kalojnë.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

E hedhim në votim kush është pro kundrejt propozimit që bëri zonja Doris.

Kush është kundra?

### **Altin Mecja-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Sot duhet të ishte vetëm buxheti asgjë tjetër

### **Blendi Himci-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Luti një sek se po e drejton dhe shumë keq pyetjen, ti ke pjesë të rendit të ditës për shtesat që kalojnë me procedurë të përshpejtuar dhe normalisht për shtesat do

ngresh një votim dhe jo kush është propozimi I Dorisit,të lutem shumë ndiq rregulloren lexoje rregulloren po ta them shumë sinqerisht pra rendin e ditës e ke,miratimin e rendit të ditës për ato pika që kë që kanë qënë të miratuara dhe në komisione për të gjithë pikat shtesë do të ketë një votim të posacëm ju nuk mund ti bashkoni dy votimet njëkohësisht të lutem shumë mos e shkel procedurën

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Janë propozime që dha Znj.Doris që të hiqen kto shtesa dhe unë po I them këshilltarëve jeni pro që ti heqim.Nga koferenca e kryetarëve deri tek komisionet ne shtuam nja tre katër gjëra

### **Blendi Himci-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kjo kërkon 2/3 e votave pra kërkon 31 vota nëse ti do ti bësh 31 vota bëji.Lexoje rregulloren për të gjitha pikat që janë shtuar pa kaluar në komision janë pika që kalojnë me procedurë.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Të vetme pikat që nuk janë diskutuar në komision janë pikat për qytetar nderi tek të cilat Znj.Rudina ishte present

### **Blendi Himci-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Dhënie e qytetar nderit ka një format të rëndësishëm dhe nuk është ashtu sic thotë Znj.Ferra që kto sjanë ndonjë gjë e shikoj që të kemi dhe ne bindje kur të ngrmë kartonin për kto persona që do ti jepet qytetar nderi.Unë se kam lexuar realisht ta them nuk e di fare kush është ktu po jua them shumë sinqerisht

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Për qytetarët e nderit është mbledhur grupi dhe ky grup është mbledhur është si traditë meqë janë dhe festat e fundvitit që të dekorohen disa qytetra nderi

### **Blendi Himci-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Atëherë ndiq procedurën

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kush është pro propozimit të Znj.Doris

### **Esmeralda Mallosi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Pikat 18,19,20,21,22,23 deri tek pika 26 dhënia e qytetra nderi për të gjithë kta persona sigurisht që kanë kaluar në komisione të cilën ne vetë e kemi

### **Altin Mecja-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Është komision këshillimor ai jo komision vendimarrës

### **Zamir Muzhaqi-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Unë bazohem në rregulloren e këshillit Bashkiak shumë mirë e tha Blendi pikat që janë shtuar duhet të kalojnë me 2/3 e votave,nuk na kanë ardhur në komisione sipas rregullores na kanë ardhur me vonesë dhe nuk kalojnë

### **Gledian Llatja-Kryetari I Bashkisë Elbasan**

Kemi diskutuar dhe më përpara që të ngrihej një pleqësi,e cila u bë publike që në mbledhjen e kaluar që nga mbledhja e kaluar ku u bë njohja zyrtare e tyre.Jane bërë mbledhje me anëtarët e komisionit të vlerësimit të figurave kanë miratuar një rregullore të përbashkët ku kemi diskutuar mbi dokumentacionin dhe kemi shqyrtuar ato kërkesa që na kanë ardhur.Dhe nga ato kërkesa që na kanë ardhur jo të gjitha janë ktu prezente kemi vendosur dhe disa rregulla të brëndshme.Nuk ka pasur problematika nga asnjë nga anëtarët e kryesisë është dhënë vlerësimi nga anëtarët specifikisht për cdo emër dhe është sjellë në këshillin bashkiak duke qënë se është fundi vitit dhe për mbrëmjen gala që organizon bashkia të bëhet dhe ndarja e disa cmimeve sic ka qënë traditë tashmë.Kjo ka qënë arsyeja që janë sjellë në këtë mbledhje pas marrjes së vendimit.Qëllimi ka qënë që të bëhet ndarja e cmimeve në mbrëmjen Gala ashtu sic ka qënë traditë

### **Ergys Muzhaqi-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Unë jam anëtar I kësaj kryesie dhe Zoti Kryetar ne kemi rënë dakord që për astë nxitimin qe figurat e përcaktuara të futeshin në mbrëmjen gala ne si kryesi meqënëse kemi vetëm funksion këshillimor ju këshilluam që propozuesit të plotësonin më mirë dokumentacionin disa prej figurave që nuk e kishin të plotë ju këshilluam dhe ju që të ndiqni hapat e duhura për tafatur në procedurë të përshpejtuar në këshillin bashkiak prat ë lajmërohet këshilli bashkiak të lajmërohet komisioni qoftë dhe me një sms në ehats up ju nuk e keni bërë prandaj këshilltarët e opozitës janë të shqetësuar sepse shkelet rregullorja nuk e kemi problemin tek emrat,problematika

që po ngrejmë për ti miratuar në rend të ditës kto bazohet në atë që nuk I keni ndjekur hapat e duhura sipas ligjit.

**Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Duke pasur parasysh e keni të gjithë përpara rendin e ditës duke filluar nga 18-26 hiqen nga rendi I ditës dhe pika e marrveshjes ndërmjet bashkisë Elbasan dhe akademisë së Shkencave të Shqipërisë

**Artur Guni-Përfaqësues I Administratës Bashkia Elbasan**

Përshëndetje, e para më vjen keq njëher që I dëgjoj fjalë për qytetra nderi kur tek mbledhja e komisionit kanë qënë dakord, shkelim ligjin ky ligj votoni dhe nuk e shkelni ligjin. Ndërsa tjetër që ndërhyra më shumë është marrveshja me akademinë e shkencave kjo marrveshje është thjeshtë nëse nuk miratohet tani ngelet pa shërbim, është për të gjithë lexuesit që lexojnë online kto jnë rëndësitë e saj dhe nuk mendoj që duhet ta kaloni aq lehtë është një vlerë financiare shumë e vogël mund ta shikoni dhe është pjesë e buxhetit dhe nuk shoh arsye ktu mos ta votoni.

***Pika e parë miratimi i rendit të ditës.***

Këshilli Bashkiak miraton me shumice votash sa më sipër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.12.2024, ora 10:20 në ambientet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Kruetari I Bashkisë Elbasan Z.Gledian Llatja Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

**Pika e dytë e rendit të ditës**

### **2.Miratimi I procesverbalit të muajit Nëntor 26.11.2024**

Këshilli Bashkiak miraton me shumice votash sa më sipër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.12.2024, ora 10:20 në ambientet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Kruetari I Bashkisë Elbasan Z.Gledian Llatja Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

#### **Pika e 3 dhe 3.1 e rendit të ditës**

**3.Mbi miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi I bashkisë për muajin Nëntor 2024**

**3.1.Mbi miratimin e ndihmës ekonomike nga fondi I kushtëzuar për muajin Nëntor 2024.**

Këshilli Bashkiak me 40 vota pro, - kundër, 1- abstenim, miraton sa më sipër.

(V.A E.Muzhaqi)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.12.2024, ora 10:20 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Kruetari I Bashkisë Elbasan Z.Gledian Llatja Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

#### **Pika e katërt e rendit të ditës**

#### **4.Plani I punës dhe aktivitetetve,Konsultimeve Publike dhe Buxheti I Këshillit Bashkiak Elbasan për vitin 2025.**

### **Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Marr shkas dhe nga debate që bëme për rendin e ditës në mbledhje duhet ti ishim detikuar totalisht pikës më të rëndësisme.tek ky plan mesa lexova ke të parashikuara që janë 12 mbledhje dhe 4 mbledhje jashtë radhe të parashikuara tek ky plan dhe ne ta mendojmë që në muajnin dhjetor të bëhet një mbledhje jshtë radhe dhe të diskutohen të gjitha kto pikat që na hëngrën kohë një orë tani ti kalojmë në një mbledhje jashtë radhe gjithmon në muajin dhjetor dhe në mbledhjen e fundit të lihet vetem pika e buxhetit ktë kisha si ndërhyrje meqë jemi tek mirartimi të parashikohet dhe të lihet si rregull që në muajin dhjetor të bëhen dy mbledhje një jashtë radhe

Këshilli Bashkiak me 26 vota pro, - kundër, 1- abstenim, miraton sa më sipër.

(V.A E.Murataj)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.12.2024, ora 10:20 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Kruetari I Bashkisë Elbasan Z.Gledian Llatja Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

#### **Pika e pestë e rendit të ditës**

#### **5.Për vendosjen në institucionet rezidenciale të shërbimeve sociale të Z.Vasil Qosja dhe Z.Mustafa Kurti**

Këshilli Bashkiak me 41 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.12.2024, ora 10:20 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Kruetari I Bashkisë Elbasan Z.Gledian Llatja Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

#### **Pika e gjashtë e rendit të ditës**

#### **6.Për propozimin e krijimit të bashkëpunimit midis Bashkisë Elbasan dhe komunës së Preshevës,Serbi**

#### **Gledian Llatja-Kryetari I Bashkisë Elbasan**

Kemi pasur një ndërveprim me komunën e Preshevës,është një komun me 34% me popullsi shqiptare në republikën e Serbisë dhe një ndërveprim ndërmjet institucioneve tona.Komuna e Preshevësh është një nga komunat kryesore me numrin më të madh të popullsisë shqiptare në republikën e Serbisë dhe është një komunë e cila ndodhet ndërmjet Bullagrisë Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës,Meqë kemi pasur si traditë dhe si qytet si shkolla normale me bashkëpunim dhe nderveprimin kulturor dhe artistik me bashkitë e tjera dhe po e forcopjmë dhe me komunën e Preshevës.Ktë vit për herë të parë ku Universiteti I Elbasanit me Bashkinë e Elbasanit mbulon shpenzimet për pesë student të ardhur nga Presheva në kuadër dhe të një bashkëpunimi që kemi pasur.Unersiteti Aleksandër Xhuvani I jep bursat dhe mbulon shpenzimet e shkollimit dhe bashkia Elbasanit falë dhe miratimit tuaj si Këshill Bashkiak I kemi mbuluar shpenzimet për qëndrimin ne konviktin e universitetit.Ky është një bashkëpunim I mire mendojmë që do të bëjmë bashkëpunime të tjera me kominën e Preshevës për të forcuar lidhjet tona për të rritur jetën kulturore dhe artistike për bashkimin evropion.Eshtë një bashkëpunim I mirë që dhe elbasani të marri eksperiencia nga bashkitë e tjera,të japim kontibutin tonë për të forcuar marëdhëniet dhe me bashkitë e tjera.Kemi pasur një visit zyrtare para disa ditësh në Preshevë,për aktiviteti të qyteteve tona.

Këshilli Bashkiak me 41 vota pro, - kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.12.2024, ora 10:20 në ambientet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Kruetari I Bashkisë Elbasan Z.Gledian Llatja Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

**Pika e shtatë e rendit të ditës**

**7.Mbi dhënien me qera dhe në përdorim (rinovim kontratash) të disa ambienteve nga Bashkia Elbasan**

### **Shfaqet Bullari-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Atëherë janë thjesht dhënie me qera rinovim kontratash për 5 objekte të Bashkisë Elbasan,dy subjekte private dhe 3 të tjera sipas vendimit të qeverisë janë kontrata që janë përsëritëse,besoj që duhet të votohen

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kjo pikë do 31 vota të kaloj shikojeni dhe gjykoheni vetë.

Këshilli Bashkiak nuk miraton sa më sipër.

26 vota pro,6 vota abstenim

(E.Muzhaqi,A.Domi.B.Copja,D.Cepa,A.Kana,A.Murati)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.12.2024, ora 10:20 në ambientet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Kruetari I Bashkisë Elbasan Z.Gledian Llatja Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

#### **Pika e tetë e rendit të ditës**

**8.Mbi miratimin e formulës së pikëzimit për aplikantët në programet e strehimit social**

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

**Kush do ta relatoj,nga bashkia kush ishte?**

### **Gledian Ilatja-Kryetari I Bashkisë Elbasan**

Është një lajm I mirë në fakt që ne në bashkinë tonë për herë të dytë po hapim kreditë e buta,kreditë e buta është një ndihmë që I vjen cifteve të reja të cilat do të jepën për 85 familje të reja në bashkinë e Elbasanit për ti ardhur në ndihmë atyre të cilët duhet të blejnë një banesë ku interesi banker do të jetë maksimumi der ne 3% për të gjithë kohën e kredimarrjes dhe institucinet bankare qe janë miratuar nga ministria e financave për të marrë të kredi nga banka me një interes stabël.Kjo është një gjë shumë positive për të rinjtë e zonove rurale apo dhe për ato të cilët janë të pastrehë por dhe për ato nënat e vetmuara me fëmijë për të marrë një kredi të butë nga bashkia Elbasan për të sistemuar jetën e tyre,duke I sistemuar në një banesë,është një model shumë mirë që ne e kemi aplikuar dhe para dy vitesh kjo është faa e aparë dhe shpresojmë shumë që vitin tjetër të kemi një numër më të lartë të aplikuesve dhe te kuotave që kemi për kredit e buta,është një ndihmë e madhe që I jepet të gjithave familjeve të reja në Elbasan.Janë 85 familje të cilat do të përfitojnë të marrin kredinë e butë sipas parashikimeve ligjore dhe vendimeve të marra nga qeveria shqiptare dhe ministria e ekonomis kulturës dhe informacionit për të akurduar kto kredi për qytetarët



## **Valbona Balliu-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

I nderuar Zoti kryetar të nderuar kolegë pikë së pari në komisionet e strehimit në të cilin ishim prezent ne nuk e kaluam në komision këtë pikë dhe arsyeja e vetme ka qënë ne nuk jemi kundër subnsionimit të qerasë për familjet e reja dhe në ndihmë të familjeve në nevojë problem është që ne kërkuma transparencë të plotë mbli listën e aplikantëve,kërkkuam transparencë se si është zbatuar kjo formulë me aplikantët paraardhës pasi ka një problematik të thellë duke menduar që tek miratimi I qerasë nga bashkia ne vumë re shumë parregullsi të cilat do ti cojmë në organet kopetente.Kërkkuam nga ju nga administrate e bashkisë të na vini në dispozicion sa pikë kishte fituar dhe cfarë kriteri kishte plotësuar cdo anëtar I asaj liste,sepse aty të paktën mbi 10 rastë kishtë një parregullsi pra nuk ishte respektuar kriteret dhe kërkkuam nga bashkia ky komisioni I cili ka miratuar kto dhënie qerasë a mbanpërgjësi për shkeljet ligjore të aplikantëve sepse na u tha që aplikantet e mbajnë vetë përgjësinë ligjore po ky komision kjo administratë që paguhet nga taksat e qytetarëve nuk mban kurëfarë përgjësie sepse thonë këtë e kontrollon kryetari I komunës se kryetari I komunës se kryetari komunës sjell lista.Zotri duam transparencë të plotë atë listën në të cilën janë 309 familje në të cilën drejtoresha doli në një konferencë për shtyp drejtoresha e sektorit përkatës dhe tha janë 275 familje.tani ne nuk e dimë janë 275 familje apo janë 309 familje,e dyta kto 309 familje të lutem duam të dimë emër për emër cfarë kriteri ka sëcila prej tyre mbi cfarë lloj pikëzimi kanë përfituar ato dhe janë përjashtuar familjet e tjera.Zonja Jeta nuk kam mbaruar nëse nuk e keni durimin e duhur,për transparencë I duam taksat e qytetarëve ku shkojnë kaq kërkkoj,kto familje vërtet e meritojnë që tu sunvencionohet qeraja apo janë thjesht coka elektorale.Të lutem zoti Lala mos më nderprit kur flas as ju dhe as antarët e tjerë.Kërkkuam listën e kërkkuam në komision na thanë që do e sillnin nuk e sollën dhe në kto momente që ne flasim kemi disa muaj që kërkkojmë trasparencë mbi këtë situatë.

## **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kto janë disa kriteret dhe kushte mbas ligjit,ne po flasim për kreditë e buta ti dole tek subencioni I qerasë.lidhur me cështjen që po flasim në rastin konkret janë tre pika miratimi I formulës së pikëzimit.

### **Gledian Ilatja-Kryetari I Bashkisë Elbasan**

Sëshhtë fare e drejtë të hedhësh baltë mbi njerzit dhe të përfitosh mbi këtë situatë.transparencën e ke aty dhe I gjithë dokumentacioni është aty

### **Valbona Balliu-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Mungesa e transparencës mua më con që ktu ka dicka që nuk shkon

### **Gledian Ilatja-Kryetari I Bashkisë Elbasan**

Të lutem shumë tani se të dëgjova është miratuar pikëzimi në bazë të kriterëve komisioni ka bërë vlerësimin e aplikantëve dhe do ti sjellin nëse nuk I ke marrë janë të gjitha dosjet aty sepse ska asnjëri gjë për të fshehur dhe e gjithë kjo gjë që po bëni është thjesht për të mos u miratuar kreditë e buta për familjet ashtu sic nuk miratuar as ushqimin për familjet në nevojë tek ADU-bëja për dhënie me qera e ambjentit pa pagesë për familjet në nevojë të cilat janë 120 familje që hanë tek adu-bëja në bashkëpunim me bashkinë ushqim falas dhe ju nuk e miratuar ambjentin që bashkia do ti japë me qera një organizatë jo qeveritare e cila në datë 1 janar sipas vendimit tuaj duhet të mbylli derën dhe të mos jepet më ushqim falas për familjet e Elbasanit kjo është e turpshme.Apo për fëmijët të cilët e gjimnazit dhaskal todri të cilët marrim mësimet e tikut mbasdite tek oraganizata e cila ofron kto kushte dhe për atë e refuzuar.Në datë 1 janar ju e kuptoni që bashkia e Elbasanit bashkë me ADU-bënë,nuk ka një ambjent që të afroje ushqim falas për familjet në nevojë do ta mbylli derën sepse ju nuk I miratuar ambjentin me qera që është mbrapa konviktit të shkollës së muzikës të njëjtën gjë në këtë formë doni të bëni dhe për kreditë e buta për familjet në nevojë dhe për çiftet e reja dhe gjeni cdo lloj arsyeje.Listen e keni miratuar ju në këshillin bashkiak.Dhe tani nuk miratoni ambjentin me qera të një oragnizate e cila ofron ushqim falas që ndihmon bashkinë e Elbasnit dhe familjet në nevojë të bashkisë se Elbasanit.

### **Ermira Urupi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Zoti Lala dhe të gjithë këshilltarët deri sot kemi bërë shpirtërisht dhe moralisht detyrën që edhe kur na është goditur faqja e majtë kemi kthyer të djathtën dhe nga sot ju zot ilala dhe të gjithë ju ktu present sësë do duhet të përgjigjeni me të njëjtën gjuhë të fjalorit të xhepit do përgjigjemi.Tani pala tjetër ka Akoma atë entuzjazmin të protestës së rrugës dhe ne kemi detyrën e të bërit të punës të përfaqësuesve të qytetit respektë për kryetarin e bashkisë dhe për të gjithë punonjësit e Bashkisë.do

zhurmë zoti Lala jemi zë I parë do nivel të ulët nuk do të jetë pjesë e jona por do të jetë kthim përgjigje nga sot e deri në cdo moment.

Këshilli Bashkiak me 30 vota pro, - kundër, 4 - abstenim, miraton sa më sipër.

(V.A V.Balliu,A.Kana,D.Madhi,E.Murataj)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.12.2024, ora 10:20 në ambientet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Kruetari I Bashkisë Elbasan Z.Gledian Llatja Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

#### **Pika e nëntë e rendit të ditës**

#### **9.Për miratimin e ngritjes,përbërjes dhe funksionimit të Komisionit të strehimit**

Këshilli Bashkiak me 30 vota pro, - kundër, 4 - abstenim, miraton sa më sipër.

(V.A V.Balliu,A.Kana,D.Madhi,E.Murataj)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.12.2024, ora 10:20 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Kruetari I Bashkisë Elbasan Z.Gledian Llatja Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

#### **Pika e dhjetë e rendit të ditës**

#### **10.Mbi miratimin e fillimit të procedurave për zbatimin e programit social të strehimit “Subvencioni I Interesave të Kredisë”**

Këshilli Bashkiak me 37 vota pro, - kundër, 2 - abstenim, miraton sa më sipër.

(V.A E.Murataj,A.Mecja)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.12.2024, ora 10:20 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Kruetari I Bashkisë Elbasan Z.Gledian Llatja Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

#### **Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës**

#### **11.Miratim dhënie burse për nxënësit e arsimit parauniversitar dhe arsimit profesional për vitin shollor 2024-2025**

### **Evis Stafa-Përfaqësuese e administatës së Bashkisë Elbasan**

Në muajin shator janë hapur aplikimet për përfitim burse për të gjithë shkollat e arsimit parauniversitar përfshirë ktu dhe shkollat e arsimit profesional,në total kanë aplikuar rreth 1010 nxënës nga kto 725 nxënës plotësojnë kriteret sipas VKM 666,200 nxënës janë përfitues burse tek arsimi parauniversitar ndërsa 471 nxënës janë të arsimit profesional 54 nxënës janë nga arsimi special pra në total janë 725 nxënës përfitues që plotësojnë kriteret sipas VKM

### **Sokol Sinani-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Nuk kane kaluar bursat e vitit 2022-2023 për disa nxënës nuk e di ska pas fonde nëse mund ti rregullojmë ndonjë fond që dhe kta fëmi ti marrim ato që I takojnë përderisa ka pas një vendim të këshillit bashkiak

Këshilli Bashkiak me 40 vota pro, - kundër, 1 - abstenim, miraton sa më sipër.

(V.A E.Murataj)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.12.2024, ora 10:20 në ambientet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Kruetari I Bashkisë Elbasan Z.Gledian Llatja Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

#### **Pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës**

**12.Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2025 si dhe miratimin e programit buxhetor afatmesëm përfundimtar për periudhën 2025-2027**

### **Gledian Llatja-Kryetari I Bashkisë Elbasan**

Përshëndetje të nderuar antarë në fakt sot është një mbledhje e rëndësishme e Këshillit Bashkiak sepse parashikohet buxheti për vitin 2025 do të ndalemi në disa tema specifike un do të bëj një rezume të punëve të bëra në buxhërin e vitit 2023,2024 dhe në atë që parashikohet në vitin 2025.

#### **Në vitin 2023 kemi bërë:**

Përmirësim i infrastrukturës kryesisht në zona informale që janë në proces legalizimi (Ndërtim i linjës KUZ-së në lagjen 5 Maji, rruga "Arif Dardha" dhe rruga "Xhaferr Belegu

Loti III : "Mbrojtja e rrugës Papër - Pajun - Papër Sollak nga përroi i Paprit, Njësia Administrative Papër"

Rikonstruksion i palestrave dhe terreneve Sportive, Shkolla e Mesme e Bashkuar "Luigj Gurakuqi", Elbasan

Mbrojtja e rrugës së fshatit Bujaras nga përroi Gostimës, Njësia Administrative Gjergjan

Rikonstruksion i gjendjes faktike, i shesheve të pallateve 41, 41/1,41/2, 41/3 et

Ndërtimi i murit pritës të rrugës së varrezave të fshatit Shirgjan, rruga Shkira

Veshja me beton në kanale ujitëse në disa zona rurale

Rikonstruksioni I rrugëve në 11 Nëntori

Rikonstruksion i gjendjes faktike të rrugës "Marije Buda" dhe "Hamdi Roseni

Rikonstruksion i gjendjes faktike të rrugës Azmi Stringa dhe 10 Korriku, lagja V. Xhuvani

Përmirësimi sistemit të ndriçimit në pallatin e sportit Tomorr Sinani

Ndërtim rrjeti KUZ në zonat informale

Kendi i lojrave për shkollë "Qamil Guranjaku" në Bashkinë Elbasan

Rikonstruksion, shtesë 4-kat dhe palestër, Shkolla Artistike "Onufri (e mesme e bashkuar)

"Ndërtim i rrjetit të hidrantëve për Krastën"

"Ndërtim muri mbrojtës të rrugës së varrezave të fshatit Labinot Katund, Njësia Administrative Labinot Mal"

"Riparim i argjinatures mbrojtëse te Perroit Zaranike"

"Ndërtim muri mbajtës dhe sistemim i perroit Gjonme"

"Ndërtim i urës që lidh rrugën 'Papri' me rrugën 'Xhikzonjës' në përroin Gostimë (faza e 2) në fshatin Bujaras, Njësia Administrative Shirgjan"

Përforcim themeli i këmbës së urës me hapësire drite 17m në Përroin e Xibrakës

Rikonstruksion i shkollës mesme "Kostandin Kristoforidhi (rikonstruksion + shtesë anësore 4-kat dhe palestër

Rivitalizim urban i qendrës së Gjinarit dhe Fushëkuqes

**RIKONSTRUKSION DHE RIASFALTIM I GJENDJES EKZISTUESE TE RRUGEVE DHE SHESHEVE NE BASHKINE ELBASAN**

Rikonstruksione ne objekte arsimore

Riparime dhe mirëmbajtje të objekteve arsimore

"Përmirësim i infrastrukturës kryesisht në zona informale (Rikonstruksion i gjendjes ekzistuese të rrugës "Arif Dardha").

Investime në fushat sportive (Impjanti i vaditjes dhe drenazhit, në fushën e kompleksit "Shefqet Lamçja dhe rikonstruksioni i terreneve sportive të shkollës së bashkuar Shushicë")

“Rikonstruksion i ambjenteve të zyrave të ASHP-së, Lagja ‘Visarjon Xhuvani’ ”

"Rikonstruksion ofiçina e ASHP-së"

Nga fondi shqiptar I zhvillimit:

Nderhyrje Rigjeneruese ne blloqet e banimit per projektin Rikonstruksion I fasadave ,Lagjia Emin Matraxhiu ,Bashkia Elbasan 2023 faza 2

Segmenti rrugor qender gjinar-liqeni Pashtreshit

Permisimi I shtresave rrugore ne disa akse te bashkise elbasan faza 2

Rr. Theofan Popa

Rr. Emin Haxhi Ademi

Rr. Demir Sulcebe

Rr. Refik Myftiu

Rr. Mahmut Hakani dhe Isak Shehu

Rr. Rrapush Demeti. Adem Zenel Hoxha, Hysen

Caushi

Rr. Bukurosh Sejdini dhe Agim Kajanaku

Rr. Ramazan Sina dhe Agron Graceni

Rr. Pusi qe lahet vete

Rr. Mustafa Skuqi

Rr. Xhemal Myhedari

Rr. Tomorr Domi (ish konservimi)

Rr. Dylaver Shkodra dhe Dhimiter Papparisto

Rr. Fiqiri Balza

Rr. Ibrahim Duka dhe Simon Shuteriqi



Rr. Reshit Celirama

Rr. Ymer Peni

Rr. Allani Dermyshe, Thane

Rr. Pazarit Fshati Shushice

Rr. E brendshme ne fshatin Mjebes

Rr.Xhako Qender ,fshati Vidhas shkolla

Rruga Mehmet Karadaku,Haxhi Garunja ,Enver Palluqi

Rruga Ramazan Sina

Rruga Xhemal Myrhedari

Rr. Mirhimisa Zaimi

Rr. Qamil Lopari

Rr. Ne lagjen Tahiret

Rr. Sheh Mahmut Guma

Rr. Shesh para pallateve nr 500/4 dhe 500/3

Rr. Shushice- Fush Buall

**Investimet që janë bërë gjatë vitit 2024:**

Rikonstrukcioni i tregut të fruta-perimeve ne bashkëfinancim me IADSA

Rrethimi i ambjentit të QSB-së

Mbrojtja e lagjes Noneve nga gerryerja e perroit te Gostimes, fshati Polis Vale, Njesia Administrative Shushice

Ndërtimi shkollës 9 – vjeçare “Jonuz Çarçiu”, Tregan

Ndërtimi i urës mbi përroin Llinxhës në fshatin Jagodinë, Njësia administrative Shushicë dhe Rikonstrukcion i urës së përroit ‘Balta e Gaxhjes’ në rrugën e lagjes ‘Katund i Vjetër’, fshati Shushicë, Njësia administrative Shushicë

Rikonstrukcion i disa urave

Ndërtim muri pritës në rrugën Hysen Ali Kopili , lagjja 5 Maji, për mbrojtjen e dy banesave nga rrëshqitja

Rikonstruksion 2 tualetet e teatrit dhe dhomat e aktorëve

"Restaurim i plotë i Muzeut Etnografik"

“Riparime dhe lyerje të objekteve arsimore”

“Rikonstruksion në objekte arsimore”

Rindërtim i ambjenteteve ndihmëse të aktiviteteve sportive për grupmoshate nxënësve të qytetit, lagjja “Qemal Stafa

Prishje e objektit ekzistues një kat dhe ndërtimi i objektit 2 - kat me funksion çerdhe

Rehabilitimi i pellgut ujëmbledhës përroit të Zaranikës dhe Rikonstruksion i digës dhe shtratit të përroit të Zaranikës.

Restaurimi i shtepise muze “Aleksander Xhuvani

Rikonstruksion i çerdes nr.2 në qytetin e Elbasanit

Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Fadil Gurmani

Rivitalizim urban i rrotondës tek kryqëzimi “Luleve”, rrotondës “1 Maji”, rrotondës “Postës” dhe rrotondës tek “Bashkia

Rivitalizim urban i shesheve publike të pallateve 588 , në lagjjen “5 Maji

Veshje me beton e kanaleve ujtese te I dhe te II ne njesite administrative

Asfaltim i gjendjes ekzistuese të rrugës të Xhamisë, fshati Vreshtan, Njësia Administrative Shushicë

Ndërtimi muri mbrojtës nga perroi Gurra, Shushicë dhe ndërtim tombino tërthore, fshati Shushicë, Njësia administrative Shushicë, Elbasan

Ndërtimi i urës mbi përroin “Gorrej”, degëzimi i përroit Papër, në fshatin Papër Sollak, Njësia administrative Papër

Fondi shqiptar I zhvillimit:

Rikonstruksion I konviktit "Ymer Tola"

Ndërtim I tombino box dhe mbushje me zhavor (Faza I) ne funksion te AutoMoto-Park

Rigjenerim Urban I stokut te banesave (fasadat) ,Rr K.Sejdini dhe Unaza Bashkia Elbasan

Permisimi I shtresave rrugore ne disa akse te bashkise elbasan faza 2

Ndertim I rruges "Gjergj Arianiti"

Ndertim I rruges "Bexhet Hyti"

Rruga "Naim Cerraga, Hasan Bej Bicaku & Arnold Shober"

Rruga "Sheshi para pallateve 88/3, 88/4 88/5 dhe 88/9"

Rruga "Hajdar Blloshmi"

Rruga "Sava Papajani"

Rruga "Sali Hida"

Rruga "Rruge te brendshem ne Lagjen Vullnetari dhe Haxhias"

Rruga "Halit Narazani dhe Mehmet Bebeti"

Sheshi Pallateve 120; 120/1; 120/2; 120/3; 120/4; 120/7; 120/8

Rruga "Peter Dodbiba"

Rruga "Griqan Poshte"

Rruga "Hasan Bajraktari"

Rruga "Sheshi pallateve Nr.32;37/1"

Rruga "Anastas Papparisto" dhe "Hasan Dylgjeri"

Rruga "Lagjen Qyra - Xhamia - tek rruga Liceve , NJESIA ADM. GJERGJAN"

Rruga "Agim Hoxha, Hysen Dakli dhe Florenc Balla"

Rruga "Rruga hyrese Fshati Valas dhe Lugaj"

Rruga "Rruga e varrezave, Fshati Karakullak"

Rruga "Rruge e brendshme fshati Tregan,Njesia Administrative Tregan (Faza II)"

Rruga "Rruga lagjia Kecyk"

Rruga "Borodin Mitarja"

Pra kto janë disa nga rrugët që janë në proces,disa rrugë që kanë përfunduar dhe disa që do të fillojë puna kemi pasur një vonesë në fakt këtë vit për dy arsye e para për shkak të ndryshimit të manualit të cmimeve I cili u ndryshua në janar por që u bë reflektimi në muajin mars dhe kjo u bë shkak që të gjitha projektet të rishikohen me

manualin e ri të cmimeve gjithashtu dhe ndryshimi I kushteve për kopenencën teknike ku shumë nga objektet, kanë pasur dhe procedurat e prokurimit ato problematikat e veta, por e rëndësishme është që një pjesë e madhe e projekteve të parashikuara kanë hecur. Ndërko një përmbyllje vitit 2024 kemi pasur një rritje të të ardhurave me 9.14% nga viti 2023 kemi pasur një realizim të buxhetit tonë me 84 % kemi akoma për të punuar sic e thotë dhe ligji brënda muajit mars të sjellimin realizime faktike të vitit 2024. Gjithashtu kemi pasur një vit finaciari të realizura bashkia e Elbasanit vazhdon të jetë një nga bashkitë më të mira nga ana finaciare kjo e thën dhe na auditi I cili del në cdo Bashki të Shqipërisë. Kemi pasur dhe disa problematike për mosrealizimin e buxhetit dua të them dy faktorë e para është masa që u morën për debitorët që ishin dhe që vazhdojnë të jenë akoma debitor pavarësisht masave që u morën duke ju bllokuar llogaritë bankare dhe ndjekja e procedurave ligjore një pjesë e tyre vazhdojnë të jenë Akoma debitor një pjesë e tyre janë banorët ose e migrantët të cilët rezultojnë të regjistruar në regjistar tonë por janë pa aktivitet ekonomik në Bashkinë e Elbasanit. Nërko vazhdon Akoma të kemi debit nga zona industriale, kemi pasur një bashkëpunim të mirë me ministrinë e Brëndshme për detyrimet e prapambetura që ka ndërmarrja e Mjekësit ku ministrai e Mbrojtjes ka marrë përsipër të gjitha detyrimet që ka pasur ndërmarrja tarifave dhe taksat për të paguar që nga viti 2015, një bashkëpunim të tillë e kemi kërkuar dhe me ministrinë e ekonomisë për marrjen përsipër për shlyerjen e detyrimeve që kanë ndërmarrjet shtetërore në zonat industriale, ish ndërmarrja e kombinatit metarlugjik dhe me ministrin e Infrastrukturës për sa I përket infrastrukturës, shpresojmë që brënda kti viti të kemi një shlyerje të konsiderueshme që ato kanë pasur ndaj Bashkisë Elbasan. Nërkohe nga mezi I vitit 2024 kemi marrë një nismëm për ndryshimin e planit të rregullimit të qytetit e cila nuk ka ecur ashtu sic ne proshim me përshpejtimin e procedurave, ka pasur një ullje të madhe të kërkesave pasi pritet që një pjesë të madhe ta rregullojmë me planin rregullues të qytetit dhe gjatë 6 muajit të parë të vitit 2025 pritet që të sistemohen sipas parashikimit që kemi, kto kanë qënë disa nga pikat për mosrealizimin e të ardhurave për vitin 2024. Buxheti I vitit 2024 ishte 3,589,750 lekë ndërsa buxherti I vitit 2025 parashikohet të jetë 3,799,774 lekë ose gati 38 milion euro ky është dhe buxheti I parashikuar për vitin 2025 kemi një rritje prej 5.85% kemi një ulje të disa të ardhurave sic ishin parashikuar dhe në vitin 2024 të ardhurat e lejeve të ndërtimit dhe ashtu sic janë dhe disa nga të ardhur për ato që janë ne emigrim dhe nuk kanë mundësi të jenë financiarisht në qytetin e Elbasanit sic bëmë dhe vitin e kaluar ku bllokuam dhe llogaritë bankare dhe përsiri nuk është bërë e mundur që e gjithë vlera të vilet, pra kemi parashikuar një ulje në kto zëra të të ardhurave. Dua të bëj një parashikim të shkurtër dhe më pas të hymë në detaje është parashikuar që menaxhimi I shërbimeve mbështetëse, ku pagat e institucioneve shtetërore dhe të bashkisë janë rritur dhe kjo është përkthyer vetëm në 14%, çështjet ekonomike dhe bujqësi kemi një ulje prej 3.56% ku hynë një pjesë

e investimeve të kanaleve kulluese dhe vaditëse të cilat janë bërë këtë vit, mbrojtja e mjedisit është ulur me 7.2%, zhvillimi urban është ulur me vlerën 8.7%, kultura dhe sporti janë ulur me 6%, arsimi është rritur me 16%, gjithashtu dhe mbrojtja sociale është rritur 86% fondi emergjencës I cili mbahet nga bashkia është ulur me 31%. Totali I rritjes është 5.85% nga buxheti I vitit 2024 në buxhetin e vitit 2025, këto janë disa të dhëna maktore të parashkikuara nga ne për vitin 2025, si dhe ulja e të ardhurave të qytetarëve apo familjarëve të cilët nuk kanë mundur të vilen këto vite, familjet që rregjistrohen në rregjistrin e emigrantëve automatikisht duhet të hiqen dhe nga tarifat tona, mund të bëjmë dhe për këto emigrant faljen e tarifave në një kohë më mbrapa që dhe ne si bashki të pastrojmë prapambetjet vit pas vit, është ulur dhe pritshmëria që dhe një pjesë e bizneseve që kanë vite që nuk paguajnë dhe këto I ulit pritshmëritë për mbledhjen e këtyre borxheve. Kemi pasur një rritje të të ardhurave vjetore nga viti në vit me 3 ose me 4%.

Më lejoni të lexoj dhe disa nga investimet kryesore që do të kemi në vitin 2025:

Rivitalizimi urban i shesheve publike te pallateve 588, 712, etj. (Aleks Buda), ne lagjen "5 Maji" si dhe rikonstruksioni I rotondave të qytetit se pse ka qënë dhe ne buxhetin e vitit 2024 dhe është bashkuar dhe me buxhetin e vitit 2025, rrotondës "1 Maji", rrotondës "Postës". Arsimi vazhdon të mbetet një nga prioritetet tona, ku kemi bërë projektet e shtatë shkollave, gjithashtu për këtë vit bashkë me Ministrin e Arsimit do të fillojmë rikonstruksionin e shkollës Naim Frashëri është një shkollë e cila projektin e ka gati dhe është riparë me manualin e ri të cmimeve dhe po presim që këtë vit të shpallet fituese. Këtë vit do vazhdojnë punimet për disa projekte kryesore ashtu sic është rikonstruksioni I cerdhes numër 2 një pjesë e buxhetit është dhënë grand nga raiffaisen Bank, ndërtimi I një cerdheje të re përball me ambulancën, Rikonstruksion i shkollës 9 vjecare "Fadil Gurmani, Ndertim i shkollës (9-vjeçare) "Jonuz Sali Çarçiu" në tregan, e cila është një shkollë të cilën ne e kemi kërkuar pasi ka pas dhe dëmtime të theksura dhe nga tërmeti shpresojmë që brenda vitit 2025 kjo shkollë të ketë përfunduar. Kemi pasur vonesa të theksuara për përfundimin e shkollës Kostandin Kristoforidhi, janë marrë dhe masat ligjore për tu mbyllur sa më shpejtë në bazë të të gjitha procedurave. Ka pasur një përsheptim të shkollës Fadil Gurmani shumë shpejt nxënësit do të kenë një projekt të mirëmenduar nga Bashkia Elbasan. Presim dhe kemi kërkuar disa herë nga drejtorja e shkollës Zëra Jete e cila është brenda kalasë, tek ambjentet ish Shpia Kongresit të Elbasanit, nxënësit e kësaj shkolle janë në kushte jo të mira kemi kërkuar nga stafi I shkollës që të bëjnë procedurat dhe kërkesat që ne ti paraqisim në këshill bashkiak për të gjetur mundësinë për të marrë një ambjent me qëra për nxënësit e kësaj shkolle. Gjithashtu sheshi I pallateve nga Kryqëzimi I Cërrikut, kemi parashikuar që të bëjmë zgjidhjen e kryqëzimit të cërrikut ky project është futur në buxhetin e bashkisë. Rikonstruksion

i bibliotekës “Qemal Baholli”, të cilën ne duhet ta rikonstruojmë dhe disa objekte tona të vjetra në Bashkinë e Elbasanit të cilat kanë histori, kulturë dhe traditë për Bashkinë e Elbasanit. Kemi dhe disa projekte të tjera për të bërë dhe urën e Shushicës, baypasi I Elbasanit tek lagjia e byshekut dhe dyhet të ndërhyjmë për të bërë urën e byshekut dhe lidhjen e saj dhe me zonën e automotoparkut. Gjithashtu dhe sic ju thashë kemi dhe një vëmëndje të vecantë dhe për pjesën arsimore kemi pasur ndërhyrje të vazhdueshme dhe në arsim do të vazhdojmë dhe rikonstruksionet e shkollave. Gjithashtu me bashkimin evropian do të vazhdoj projektimi për sistemimin energjistik të lagjes së banesave ku përfshihen pallatet e vjetra, pallatet e reja. Kemi vazhduar dhe kemi hecur mirë me transportin public, ku me këtë buxhet kemi menduar të sistemojmë të paktën pesë stacione autobuzash në qendër të qytetit pastaj do të vazhdojmë dhe me stacione të tjera të autobuzave, kërkojmë modelt më të mira, kjo është bërë nga Gizi nga donatorë që merren me strategjitë. Brënda dy tre viteve makinat me gaz ose me benzinë të kthehen në proces energjie. Gjithashtu është parashikuar në buxhet dhe pasurimi i flotës së mjeteve është bërë ë mundur ardhja e një fadrome të re për shërbimet rurale dhe urabane ndërko jemi në pritje për shkak të afateve. Pritet që të kemi dhe një pasqyrim të flotës së makinave për mirëmbajtjen e rrugëve në zonat rurale por dhe në zonat ifarmale. I është dhënë dhe një vëmëndje e vecantë dhe bujqësisë, bujqëesia vazhdon të ketë një focus tek në pastrami i kanaleve kulluese dhe vaditëse. vazhdojmë të kemi një vëmëndje të vecantë dhe shërbimet, sistemi i parkimit me pagese dhe menaxhimi i sistemit të masave administrative nga bashkia Elbasan. Ju bëra një rezume të përgjithshme të buxhetit kemi një sërë investimesh të parashikuar në tabëlën përkatëse për infrastrukturën, mirëmbajtjen, trashëgiminë kulturore, arsimin, turizmin dhe institucione të tjera, zonat turistike sic është funari, gjinari dhe tregani. Vlera totale e buxhetit për vitin 2025 kap vlerën e 529 228 679 lekë. Kjo ishte një përmbledhje e buxhetit. Faleminderit.

### **Shfaqet Bullari-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ky projekt vendim për miratimin e buxhetit u diskutua dhe në komision me detaje, u bënë sqarimet e nevojshme për të kërkuar informacion për investimet për të gjitha rastët dhe për një dy tre rate u la porosi që të jepet informacion më i saktë sot. Para hartimit të buxhetit janë bërë ndërhyrje në të gjashta lagjet e bashkisë dhe në dymbëdhjetë njësitë administrative. Buxheti bashkisë është më i rëndësishmi i vitit në këshillin bashkiak miratimi i këtij buxheti kërkon përgjishmëri nga këshilli bashkiak i cili duhet të ngrihet mbi interes partiak dhe të gjykojë se miratimi i tij është domosdoshmëri dhe i hap rrugë administratës së bashkisë për të kryer funksionet e saj për shërbimet e nevojshme të qytetarëve dhe investimet e kërkuara

nga komuniteti. Buxheti I shërben bashkisë për të realizuar objektivat e saj të premtuara për zhvillimin e qytetit, mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e pyjeve, arsmi, sporti, kultura, turizmi, zhvillimi bujqësisë, biznesit, shërbimeve sociale etj. Buxheti I këtij viti shënon një rritje në krahasim me vitin e kaluar me 5.85% më shumë ose nga 3,799,774 mijë që është 2025 në 3,589,750 mijë viti 2024. Me rritjen e buxhetit një ndikim ka rritja e grandit të pakushtëzuar në krahasim me vitin e kaluar 14% më shumë ndërsa grandet janë rritur 23% më shumë, të adhurat e bashkisë pësojnë një ulje si rrjedhje e taksës së legalizimeve. Në rëllacionin e buxhetit që keni përpara janë për cdo zë të ardhurat dinamika e tyre dhe pesha specifike që zënë me totalin gjithashtu dhe shpenzimet për cdo program. Shpenzimet janë: pagat zënë 44% shpenzimet e përgjithshme zënë 32% dhe investimet 24%. Lind pyetja pse ka peshe specifike të pagave, rritja e pagave të bashkisë nga 1 shtatori vitit 2024 që u rriten nga 10 der ne 25% dhe rritja e pagava të funksioneve të deleguara arsimiti parashkollor, gjëndja civile dhe MZZH-ja, Një pjesë specifike transferta e pakushtëzuar 30% të totalit transferta specifike 17% të ardhurat e bashkisë 44%, të ardhurat e trashëguara 4.6%. Pra investimet zënë 24% të buxhetit ose në shifra janë 900 milion lekë nga të cilat 370 mil;jon janë të trashëguara nga viti 2024 dhe 530 milion janë investime të vitit 2025, arsyet I dini kryetari I shpjegoi në mënyrë të hollëshishme. Në pyje janë parashikuar investime të cilat marrin planin e parashtrimit nga buxheti I shtetit, në MZZH janë parashtruar me 11 milion 420 mijë lëkë. Nuk dua të ndalem sepse u përmëndën të gjitha investimet që do të bëhen në vitin 2025 sepse janë pasyruar në tre tabela e parë është tabela e onvestimeve të parashikuara që janë në process, tabela e dytë janë investimet e vitit 2025 dhe tabela e fondit të zhvillimit shqiptar e cila është pa shifra. E cila me të ardhur fondi nga fondi I zhvillimit shqiptar ne do të aplikojmë menjëher për kto prioritete që kemi. Duhet të jëmik të ndërgjegjshëm se nuk kemi një super buxhet por një buxhet modest ambicioz realist I cili nuk mund të realizohet plotësisht në 6 rajone dhe 12 njësi administrave të cilat kanë probleme pafund por me këtë buxhet bashkia është kujdesur ti plotësojë kërkesat më prioritare më emergjentë për zhvillimin e qytetit dhe përmisimin e shërbimeve të saj dhe në cilsësinë e jetës. Ftoj anëtarët e këshillit bashkiak ta miratojnë këtë buxhet që puna e bashkisë në janar të fillojë mbarë për të realizuar këtë buxhet.

### **Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Pyetja ime e parë është tek prioritetet që ka vendosur bashkia për investimet në bazë të buxhetimit me pjesëmarrje A janë pasqyruar drejtë kto pikat të cilët qytetarët I votuan dhe shqetësimet që ngritën qytetarët në këtë projekt buxhet investime? E dyta ka një raport të investimeve të realizuara në vitin 2024, kam një javë që kam kërkuar një raport të detajuar sesi kanë shkuar investimet e vitit 2024 dhe nuk e kam pyeyja është konkrete



Janë pasqyruar apo jo sipas buxhetimit me pjesëmarrje prioritete e bashkisë apo janë vendosur prioritete që ka dashur ky zotria ktu.

### **Bianka Copja-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Përshëndetje të gjithëve pyetja ime lidhet me buxhetin e vitit 2024

Sa është përqindja e mosrealizimit të këtij buxheti dhe sa është vlera që kalon në buxhetin e vitit 2025. Cilat janë kto investime që nuk janë bërë në vitin 2024 dhe që do të transferohen në vitin 2025?

### **Blendi Himci-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Së pari keqardhje kushtet në të cilat ne po zhvillojmë këtë mbledhje, është e disata herë që e zhvillojmë në kushte diskriminuese, skemi ku vendosim dokumentat kemi bë disa herë thirrje dhe keqardhja ime maksimale mos kem një tavolinë ku të vendos dokumentat, mund të jemi në një sallë ma qera dhe jo në këtë lloj situatë. E dyta që doja thoja në respect dhe të kolegëve të krahut të majtë ta respektojmë njëri tjetrin pyetjet mund të jenë nga më të ndryshmet mund të jenë dhe pyetje që ndoshta llogjika mund të jetë shumë e thjeshtë. Pyetja mbetet pyetje kush do le të përgjigjet. Ta respektojmë njëri tjetrin nëse është strategji që kush të flasi ta mbysim kjo është histori por kakufoni ktu skemi pse bëjmë ta respektojmë njëri tjetrin.

### **Gledian Llatja-Kryetari I Bashkisë Elbasan**

Ne I thamë kto gjera ishin transparente, 19% e kuptoj që kkeni probleme me matematikën ,pra është 19 % pjesa e mosrealizimit buxhetor

### **Bianka Copja-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ety jeni në detyrë për të kthyer përgjigje për pyetjet që ju bëhen janë të drejta apo jokeni këtë detyrë nëse nuk doni të përgjigjeni thuja nuk dua të përgjigjem është kaq e thjeshtë

### **Gledian Llatja-Kryetari I Bashkisë Elbasan**

Pyetja ishte aq e thjeshtë sa unë që në fillim të fjalës time këtë gjë thashë dhe Shefqeti po të njëjtën gjë tha sa lekë transferohen tek ky vit I mora të gjitha materialet investimit ku ishin dhe ku jo dhe çfarë faze ishin ku janë të vazhdojmë punimet dhe kush është në fazë që janë lidhur kontratat kush janë në fazë që kanë filluar punimet dhe kush janë në fazë të cilat priten që të fillohen punimet. Ashtu sic është rrethrotullimi 1 majit, posta dhe rrethrotullimi tek lulet tek të treja kto janë hapur disa herë procedurat nuk ka pasur dhe trashëgohet për vitin tjetër. Projektet të cilat trashëgohen janë ato të cilat nuk kanë filluar akoma prokurimet janë në fazë prokurimi ashtu sic është dhe salla e këshillit bashkiak që janë hapur procedurat e

prokurimit dhe është në fazë vlerësimi dhe pritet vlerësimi I komisionit dhe e njezat gjë dhe për një pjesë tjetër disa janë vlersuar disa janë në fazë ankimimi dhe kto fonde që janë gati 3.5 gati 3 milion dollar që nga ky vit kalojnë në vitin tjetër për këtë arsye.

### **Doris Madhi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Pyetja ime e parë është në përqindje sa është realizimi I të ardhurave në Bashkinë Elbasan gjatë vitit 2024? Në lidhje pastaj me shpenzimet nuk po mrrrem paraprakishit se jemi në fazën e pyetjeve por një pyetje që do ju duket pak ironike përse I përket pjesës së trajtimit dhe menaxhimit të kafshëve endacakë kamë parë që në zërin e pagave kemi shpenzime rreth 2 milion e 640 mijë ndërsa si shpenzime operative kemi vetëm 2 milion lekë lind pyetja cilët janë kafshët që trajtohen me pak në qytetin e Elbasanit që janë më të mëdhaja pagat sesa shpenzimet për ti mirëmbajtur kto kafshë? Pyetja ime e tretë gjithmon lidhet me inceneratorin dhe me shpenzimet pse vazhdon dhe paguhet me të njejtat para të kontatës nga të ardhurat e taksave të mbledhura nga qytetarët e elbasanit një incinerator jo funksional, një incinerator tashmë I shpallur dhe I proceduar dhe me oraganet kopetente për të cilën ka pasur dhe dënime, Ju jeni konshient sot që incinertori nuk punon kemi pasur dhe administratorët prezent që na ka bërë të ditur kto pse e paguani Akoma inceneratorin kjo është pyetja?

### **Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Buxheti I përgjithshëm 81% të realizur por ktu keni kamufluar shum bukur doja tju pyesja specifikisht për zërin e investimeve sa është në përqindje realizimi I investimeve për vitin 2024? sepse 81%, 100 ju e keni realizimin me pagat me ato rrogat që keni dhe kjo jua rrit përqindjen. Unë dua specifikisht në zërin e investimeve sa ishin parashikuar 28%, ju e keni 100% dhe keni realizur 60% po 40% kjo është dhe pyetja në mënyrë të thjeshtësuar që ta kuptoni?

### **Altin Mecja-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Unë doja ti bëja disa pyetje kryetarit dhe vjet kur u bë buxhetimi me pjesëmarrje dhe sivjet në labinot fushë u renditën disa pika dhe un do ti them popullorshe. Me ujësjellsin e Xibrakës, rruga Qarretit, Rruga e varrezave në Griqan, ujësjellës kanalizime në Mengël, rruga allushëve që shkon ën labinot mal, ujësjellsi në labint mal, rruga polist të vogël, ujësjellsi, rruga pobratit kam qenë dhe vetë janë renditur vjet dhe sivjet besoj. për mua reforma ka dështuar se dhe unë po të isha kryetar bashkie do të merresha me qytetin jo me katunin

### **Aurora Domi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Për sa I përket buxhetit të 2025 është aq I bukur ishalla realizohet kam një pyetje që e bëj për herë të tretë dhe tek zëri 2025 është tek ato investimet e lëna ose të porealizuara 800 nxënësit e shkollës Kostandin Kristroforidhi dhe familjet e tyre bashkë kur do të fillojë shkolla të funksionojë normalisht sipas një kontate që ju e kni bërë dhe në këshill unë nuk kam qenë prezente kur ju na e keni prezantuar.a mund ta di kjo shkollë cafrë fati ka dhe kush po e pengon që po zgjat tre vjet në rikonstrukcion që shkolla është gati,unë ju kam ndejkur dhe ne facebook ku ju gjate gjith vitit keni thënë që në shtator fillon dhe Akoma nuk kemi marrë një përgjigje jo vetem nga drejtorët së ndoshta ta nuk e dinë port ë paktën nga ju nuk është hera e parë është hera e tretë që jua bëj pyetjen juve drejtpërdrejtë.Cfarë po bëhet me këtë shkollë dhe me nxënësit e kësaj shkolle?

### **Rudina Mita-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ktu shikoj që citohet në këtë program buxhetor bashkia Elbasan ka një fond shpenzime për trashëgimi culture,në tabelat për trashëgimin kulturare shikoj që shpenzimet janë zero.A mund ta di si mund të promovohet kjo trashëgimi kulturore?

### **Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan**

Për zërat specific janë zëra që janë në programe të ndryshme buxhetore,pra ka buxhet specifik për të gjitha dhe per sportin,infrastruktura sportive,kulturën,artin pronovimin e kulturës të gjitha janë të buxhetuara sipas zërave.sholla Konstandin kristoforidhi ka pas vonesa për shkak se ka probleme me kaldajat nuk është marrë në dorzim shkolla dhe kjo ka qenë një nga problematikat më të mëdhaja që ka pasur.Por pjesa kaldajave është kryesorja dhe sot nuk e dim se kur mund të vin und të vin ne fillim të janarit apo në fund të janarit,janë dhe gjera të vogla pjesa e pastrimit që nuk përbejnë një problematik të madhe.Për sa I përket investimeve që kërkohen nga këshilltari për pjesën e labinotit mal dhe labinotit fushë një gjë është e vertet që ne kemi bërë investime shumë tani po bëhen investime në shushicë në mënyrë të vazhduaeshme,rruga griqan poshtë.në 2021 është bëra rruga e griqanit posht,rruga e griqanit lart janë bërë rrugët e labinotit mal dhe degëzimet e rrugëve të brëndëshme.kemi bërë rrugë në këtë 5 vjecar si nga fondet e bashkisë ashtu dhe nga fondet e qeverisë dhe nga fondi shqiptar I zhvillimit dhe prap do të bëjmë rrugë.Përsa I përket trajtimit të mbetjeve,pse e paguani inceneratorin ne paguajmë trajtimin e mbetjeve në impiantin e trajtimit të mbetjeve dhe trajtimi I mbetjeve ka një kosto dhe është detyrë funksionale e pushtetit vendor të merret me menaxhimin e mbetjeve që ka brënda territorit të vet dhe me pjesën e përpunimit të tyre.Ka problematika,ka

pafund por dhe në këtë buxhet janë parashikuar të ardhurat për trajtimin e mbetjeve. Për likuidimet janë bërë deri tani 41% elikudimit të investimeve dhe pjesa tjetër vazhdon të bëhet dhe në fund të vitit dhe me miratimin që I bëjmë sot dhe tek pjesa e grandit të qepris dhe vazhdon Akoma likuidimi I faturave.

### **Aurara Domi-Anëtare ë Këshillit Bashkiak Elbasan**

Unë në buxhet nuk pashë ansjë pikë që lidhet me OJF-të ka ndonjë pjesë të buxheetit për kto oraganozata

### **Aulona Bylykbashi-Nënkryetare e Bashkisë Elbasan**

Po I paguhet qeraja e qëndrës prej tre vitesh e cila është e parashikuar dhe për këtë vit

### **Aurara Domi-Anëtare ë Këshillit Bashkiak Elbasan**

Përvec qerasë, burmime të tjera shërbime të tjera

### **Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan**

Kishim për të kaluar për ndihmën ushqimore që ju nuk e kaluat, me një neglizhencë

### **Aurara Domi-Anëtare ë Këshillit Bashkiak Elbasan**

Nuk e kaluam dhe e di pse sepse ju fusni pesë kontrata dhe 2 të tjera që ishin për shërbimet dhe më vjen zor tani që nuk e miratova dhe tik e të drejtë tani të ma bësh këtë kundër meje ke shumë të drejtë por ti nuk mund të fusësh aty një person që mos a paguaj qeranë për objektin e vet kur mund ti thuash që jo mund ta paguash vet e fut bashkë më dikë që do ti japi ushqim të tjerëvë, mi ndaj dhe e miratoj më fut tret ë tjerë që un se kami den fare që mos paguaj. Më vjen zor mua që nuk votova por janë tret ë tjerë që uë sdua të votoj.

### **Gledian Llatja-Kryetar I Bashkisë Elbasan**

E keni pasur materialin që në komision I kisht ndarë që aty

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ju lutem dëgjoni njëri tjetrin. Zoti Blendi e ka fjalësn për të diskutuar

### **Blendi Himci-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Te nderuar keshilltare!

Qe ne hyrje te tij projektbuxheti i vitit 2025 i bashkise Elbasan pretendon te reflektoje (citoj):

”... nje qasje vizionare dhe te integruar per menaxhimin financiar dhe strategjik te qytetit tone. Ky document synon te harmonizojë burimet financiare me prioritetet strategjike dhe investimet kapitale per te avancuar drejte realizimit ten je qyteti te se ardhmes”.

Si opozitar jam plotesisht dakort me kete preambul madje do te ishte dakort edhe kryetari i bashkise psh. te Berlinit, Romes etj.

Me tej vazhdoni me vizionin tone (dmth tuaj) per Elbasanin e se nesermes si nje qytet:

- i qendrueshem dhe gjithëpërfshires,
- ku qytetaret qezojne nje infrastrukture moderne,
- qytet me sherbime efikase dhe cilesore,
- me mundesi te shumta per investime dhe sipermarrje.

Me tej vazhdoni me vizionin tuaj se tek qyteti yne:

- Shkollat ofrojne kushte optimale per edukimin e femijeve,
- Jeta kulturore dhe sportive lulezon,
- Hapesirate dedikuara perte rinjte, femijet, te moshuarit, kembesoret dhe ciklistet krijojne nje mjedis te favorshem per mireqenie dhe harmoni sociale.

Ne fund ju pohoni se

“keto prioritete jane pasqyrim i drejteperdrejte i nevojave dhe pritshmerive te qytetareve, rezultat I nje procesi gjithëpërfshiresdhe konsultimeve te gjera publike ne cdo cep administrative etj. etj. .... qe buxheti te kthehet ne nje platforme per transformimin e vizionit ne realitet duke e bere Elbasanin nje model te zhvillimit urban dhe social”.

Ne fjalen time deshiroj te mos merrem me analizen e nje sektori te vecante apo me detaje qe rendom nje buxhet mbart. E e shoh me te arsyeshme te analizoj disa tregues qe mund te na ndricojne me teper disa tipare qe e karakterizojne buxhetin tone.

## **1. Parashikimet buxhetore 2025**

- a. Taksat vendore parashikohen me ulje 23% pra rreth 1.2 miliard leke (te vjetra)me pak.
- b. Tarifat vendore parashikohen me 7 % me pak, rreth 350 milion leke (te vjetra).
- c. Te ardhurat jotatimore ulen me 7 % ose rreth 115 milion leke te vjetra me pak e ku 45% e zene gjobat nga ndertimi dhe ndaj biznesit.

**Vetem ne keto tri burime te ardhurash vendore, per vitin 2025 do te kemi ne buxhet 1 miliard e 665 milion leke te vjetra me pak.**

- d. Taksat e ndara jane te vetmet qe rriten me 28 % me efekt financiar 350 milion leke te vjetra. Ndryshimet ne burimet e tjera jane relativisht te paperfillshme.
- e. Nisur nga historia e zeze bashkia kerkon te vazhdoje huamarrjen bankare me rreth 838 milion leke te vjetra per te rritur buxhetin vjetor.
- f. Nderkohe peson rritje transfertu e pakushtezuar duke shkuar afersisht ne 13.72 miliard leke te vjetra me rritje rreth 14% krahasuar me vitin 2024.

### **Konkluzione:**

- **Te ardhurat vendoreqe lidhen kryesisht me biznesin pra me zhvillimin ekonomik ne territorin e bashkise Elbasan po tkurren.**
- **Te ardhurat nga tarifate lidhen me ofrimin e sherbimeve gjithashtu jane ne renie.**

- **Te ardhurat qe varen nga performanca e bashkise jane ne ulje.**

Ne aspektin e paraqitjes se buxhetit:

Nga faqja e shtate deri ne faqen 32 paraqiten burimet e formesimit te buxhetit ne forme tabelash permbledhese, vecmas sipas zerave, ne forme grafike etj. Shtohen faqet e dokumentit nderkohe qe te njejtat shifra perseriten. Shpjegimet e nevojeshme mbi faktoret ndikues ne buxhet e qe lidhen me vizionin e per pasoje me prioritetet mungojne teresisht.

## **2. Transfertat nga buxheti i shtetit 2025**

Transferta e pakushtezuar rritet me 30% krahasuar me nje vit me pare.

### **Konkluzion:**

- **Pesha e transfertave nga qeveria qendrore eshte rritur duke kompensuar reniet ne nivel lokal.**

## **3. Parashikimi i shpenzimeve**

Projektbuxheti, ne plot 19 faqe, vazhdon me detajimet ne linja te trashate fondeve sipas programeve buxhetore. Ne to, vec percaktimit te fondeve per secilin institucion pergjegjes jepen edhe disa shpjegime qe me teper i ngjajne informacionit pershkruar per aspekte funksionale qe mbulojne ato a thua se keshilltaret nuk i dine. Nderkohe nuk jepen dhe nuk ka realisht fare shpjegime qe do te lidhnin (nese do te kishte) shperndarjen e buxhetit me politikat lokale dhe prioritetet qeverisese ne realizim te **“vizionit”**.



Per te mos perseritur cka u tha nga keshilltare te tjere nuk mund te rri pa theksuar pak gjera:

Per fondin rezerve dhe kontigjencen jane planifikuar rreth 30% me pak. Mos valle vitin e kaluar ne kete ze ka pasur teprice fondesh apo parashikohen **me pak zjarre, permbytje e te tjera ngjarje** te kesaj natyre.

- Bashkia parashikon rreth 40 milion leke per te ashtuquajturit “**nderlidhesa**”
- Ujitja e kullimi rreth **122 milion leke punonjes per sezonale**
- Administrimi i pyjeve dhe kullotave rreth **87 milion leke per punonjes sezonale**
- Rrjeti rrugor rural rreth **90 milion leke per punonjes sezonale**
- Per **kaldaiste sezonale 32,3 milion leke**

Per turizmin parashikohen vetem **8 milion leke te vjetra**.

#### **4. Ndarja e buxhetit sipas klasifikimit ekonomik**

Ne opinionin tim ndarja sipas klasifikimit ekonomik eshte ajo qe ne tre shifra jep pasqyren e eficiences buxhetore.

##### **Duke i rrumbullakosur shifrat:**

- Shpenzime personeli 17 miliard leke (te vjetra) ose rreth 44.5% te buxhetit total.
- Shpenzime operative 12 miliard leke (te vjetra) ose rreth 31.7% te buxhetit total.
- Shpenzimet kapitale (pershire investimet) pothuaj 9 miliard apo me pak se 24% te buxh.

- Shpenzime totale rreth 29 miliard leke (te vjetra) ose mbi 76% e buxhetit total.
- Zeri “shpenzime personeli” eshte pothuaj i barabarte me te ardhurat e pavarura.
- Edhe pjesen derrmuese te transfertes se pakushtezuar e gllaberojne perseri shpenzimet.

### **Te nderuar keshilltare dhe te tjere te pranishem:**

Ne hapje te fjales sime iu referova pritshmerive per jeten ekonomike e social kulturore apo jeten e komunitetit ne pergjithesi qe synohen permes projektbuxhetit 2025. Ne fakt ato fjale na perseriten cdo vit (copi paste) ne hyrje te dokumentit per buxhetin.

Permbledhtasi konkluzionet e mija per draftin e paraqitur jane si me poshte:

Projektbuxheti edhe pse dokument financiar, pervec kuadrimin te tabelave duhet te pershkohet dhe shpjegoje politikat dhe masat e marra per realizimin e vizionit. Nje buxhet qe parashikon te kaloje rreth 29 miliard leke apo 76% (nga 38 gjithsej) vetem per rroga dhe shpenzime te tjera operative nuk mund te jete buxhet per qytetin dhe qytetaret. Jeni kujdesur per rrogat dhe komfortin e zyrave tuaja. Eshte nje luks qe do jua kishin zili qytetet e vendeve te BE. Aq me teper qe parashikohet te merren edhe 838 milion kredi nderkohe qe sherbimi i borxhit te brendshem (principal dhe interesa) eshte 400 milion. Luks me borxhe. Kesaj i thone laj nje dhe merr borxh dy sepe kemi vit elektorale.

Mireqeverisja kerkon analiza te funksionimit te cdo strukture bashkiake, vecmas dhe si pjese e se teres per te konkluduar me pas per tere bashkine si nje ansambel. Prej kohesh e gjithnje e me teper ne opinionin qytetar bashkia po perceptohet si institucion qytyk, pa vision, pa nerv, e mbytur nga paaftesia, nga mediokriteti, e

mbytur me patronazhiste e qe eshte njesuar me strukturat partiake. Profesionistet e vertete brenda njesive nuk kane ze. Te njohur tanet ngate kater anet e vendit, pas publikimit te pjesshem te pergjimeve sjelle nga sherbimet e huaja perfshire nga viti 2015, kane krijuar nje opinion per Elbasanin qe na turperon. Dhe akoma nuk eshte zbardhur pjesa politike dhe ajo e erret e qeverisjes permes te zgjedhurve tuaj permes te forteve dhe manipulimit, permes parave dhe intimidimit. Duket sikur tematika e sotme nuk ka lidhje me cfare po them. Por ka, ka dhe shume madje. Fenomenet e mesiperme nuk te lejojne te analizosh dhe kerkosh llogari, parate e perdorura ne fushata nuk jane te rrogen se funksionareve bashkiake sepse rroga eshte per familjet, favoret e kerkuara tek tefortet kane kosto qe ju i dini mire. Stafit qe te sherben politikisht nuk i analizon dot punen, nuk i kerkon dot llogari madje edhe kur korruptohet, nuk ben dot reforma strukturese sepse duart i ke te lidhura.

Duhej reforma territoriale sepse krijonte disa premisa per permiresim por jo si e bete ju.

- Kush nga ju me thote se ky buxhet do te permiresoje sherbimet ne fshat, cfare, ku dhe si?
- Kush do te me thote se ky buxhet do ndihmoje fermerin me sherbime (bujqesia, 116 fshatra)?
- Kush nga ju do te me thote se ky buxhet do te zhvilloje turizmin (cfare, si)?
- Kush nga ju me rendit 3 investime qe lene shenje per kete vit buxhetor?
- Kush nga ju me rendit 3 objektiva te qarte te aspektit social dhe mjetet e realizimit?
- Si do te mbeshteten aspekte te permiresimit te dukshem te sherbimeve si trafiku, tregjet etj.?

- Cfare do te ndodhe me rruget rurale apo permes parimit 100 punetore sezonale, nje lopate dhe vota per fushate?

Na vjen keq por reforma territorial ka vdekur si nga konceptimi edhe nga praktikat e mbrapshta qeverisese.

Cfare po them merreni si shqetesim qytetar. Per tju bindur po ju permend disa projekte te trasheguara sot e 18 vjet me pare, qe do te ndikonin ne zhvillimin ekonomik, social e kulturor dhe komfortit te jeteses se qytetit:

- Muzeu kombetar i veshjeve dhe instrumenteve popullore (qark me 38 lloje veshjesh).
- Rivitalizimi i kalase si qender atraktive e trashegimise kulturore (ne rrenim)
- Parku i Krastes
- Shtratifikim segmentesh te Zaranikes dhe Manazderes si urbanizim i periferise

Shikoni dhe krahasojeni qytetin tone me Korcen apo Shkodren, ne infrastrukture, kulture, projekte e aktivitete. Shume qytetare thone se prej vitesh e me shume Elbasani po i ngjan nje katundi te madh. Eshte ruralizuar ne mentalitet e menyre te vepruari. E them me dhimbje por eshte e vertete. Kjo nuk ka te beje me te ardhurit por me menaxhimin, lidershipin, me qeverisjen.

Te nderuar keshilltare, une nuk mund te jem dakort me kete buxhet pasi:

- Bashkia ka nevojte per rishikime strukturore analizat per te cilen nuk jane bere. Sot nuk kemi panorama te eficiences se strukturave bashkiake.
- Bashkia ka nevojte per shpopullim te institucioneve nga punonjesit parazite, nga tejngopja me te punesuar kryesisht partiake dhe jo nga nevojat funksionale.

- Bashkia ka nevojë për analize të vendit për të vlerësuar ngarkesën dhe profesionalizmin për çdo punonjës pavarësisht emrit të punonjësit.

Asnjë nga këto shtesa nuk do të ndodhë prandaj dhe shpenzimet shkojnë në 29 miliardë lekë. Ne nuk mund të lejojmë më që 76 % e buxhetit të shkojë për rroga, zyra dhe pagesa zyre.

Unë nuk jam dakort me këtë buxhet pasi:

- Gati gjysma e popullsisë që jeton në fshat pothuajse nuk përfiton gjë nga investimet.
- Përfunduar pleqet, të tjerët janë duke u dyndur drejtë qyteteve për jetë më të mirë, për shkollimin e fëmijëve të tyre, për shërbime më të mira, për infrastrukturë më të mirë. Ky buxhet nuk demonstron as minimumin e përpjekjeve për fshatin.
- Ky buxhet nuk ndihmon fare bujqësinë dhe nuk i shikon token, pyjet dhe burimet natyrore si faktore të zhvillimit ekonomik.

Unë nuk jam dakort me këtë buxhet pasi:

- Ky buxhet është shumë larg ideve dhe projekteve të përcaktuara në strategjinë e zhvillimit të qytetit.
- Ky buxhet thjeshtë shpërndan dhe kuadron shifrat por nuk garanton impulse zhvillimi për sektorët prioritarë.
- Ky buxhet vazhdon të mbështesë programe qeverisëse të korruptuara dhe të dështuara si ai i djegësit gjë për të cilën bashkia aktuale vazhdon të mos marrë masa. Ne nuk mund të miratojmë pagesa të tilla nga taksapaguesit elbasanas.

Në njëfarë mënyre ky buxhet krijon idene e rreme të një qeverisjeje gri, pa impulse, pa ngjyra. Në fakt buxheti dëshmon për paafësi të tashme të kalçifikuar, të krijuar në vite nga ju.

Ndoshta fjalet e mija duken te teperta ne rastin e nje buxheti vjetor. Ne fakt nuk jane te tilla. Kam llogaritur afersisht se per tetembedhjete vite te qeverisjes suaj ne kete bashki keni menaxhuar permes 18 buxheteve vjetore rreth 230 miliard leke dhe gjurmet e vetme qe keni lene jane bulevardi me pllaka te kuqe, zgjatimi i rruges se pedagogjikes, rruga e varrezave, parku Rinia dhe inceneratori i famshem (ky jo me fondet e bashkise). Sa per shijet urbane, investimet ne muze dhe atraktivitete te tjera me mire te mos flasim. Harrova, kemi festen e fergeses.

Nese nuk me besoni per mediokritetin, ju ftoj per nje panine me qofte shoqeruar me muzike tallava, ne sheshin para portes se kalase, sot ora 16.00. Paguaj une.

### **Bukurosh Stafa-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Unë nuk do të zgjatem kaq shumë, opozita ka te drejtë ta shikoj gotën gjysëm bosh dhe gjysëm plot. Ne nuk presim ta miratojmë opozita. Unë nuk do të futem në thellësi të diskutimit por nuk jam dakord parimisht që gjith kjo u bë e zezë sigurisht që ka vend për përmisime dhe diskutime por që të zhvlerësosh cdo gjë deri në këtë farë fejë nuk jam dakord. Të ardhurat vjetore janë realizuar pa rritje taksash, nuk ka rritje tasash dhe të ardhurat vendore kanë një rritje të natyrshme që nuk sforcon qytetarët. Nuk është një buxhet elektoral dhe nuk ndryshon shumë nga buxheti I vitit të kaluar, si përsëmbull ato sezonalet janë të njëjta me vitin e kaluar, le ti shikojmë me vëmendje, Në fakt ky buxhet ka shpenzime për personelin 44% praktikisht ka një rritje 6 përqind në raport me 2024 ku rritja e pagave ka shkuar deri në 20%. Shpenzimet kapitale që janë 24% ne jemi një bashki e cila nuk mund të mbullojë të gjitha nevojat që ka bashkia me të ardhurat e bashkisë por kemi realizuar investime shumë të fuqishme nga burime të tjera dhe nga qeveria. Shërbimet nëpër fshatra dhe qytet ka vënd për tu përmisuar por nuk është e zezë fare. Ka përmisimi të dukshem në fshat në labinot është bërë rruga nga posht deri lart me asfalt që ka qenë rrugë e keqe, në labinot katund është bërë rruga asfalt, kodër bujaras, rruga sericë, e ka bërë bashkia e ka bërë qeveria shërbimet. Ne duhet të punojmë bashkarisht ta miratojmë ktu bashkë dhe ato pika që dolën jashtë rendit të ditës ti rivotojmë. Unë kto kisha un jam dakord me miratimin e buxhetit të Bashkisë.

### **Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Përshëndetje të gjithëve në radhë të para fjala ime është për banorët e Elbasanit. Ky buxhet me 38 miliard shpenzime 5 miliard investime nuk është buxheti I Elbasanit ky është buxheti I atij zotris aty, ky buxhet nuk pasqyron ansjë pikë problematikës së Elbasanit dhe për këtë sallë ktu që shumë nga ata që kanë drejtuar bashkinë. Babai politik është populli nëna është partia secili ktu ka nënë të vecantë por baba kemi të gjithë një, dhe kur të arrijmë ta kuptojmë këtë të mos bëjmë palaqoligje politike në sy të babis politik sic bëhet në këtë sallë. Ky buxhet është pasqyra më e qartë se çfarë përfaqen ky zotria, ai zotria dhe kjo administratë nuk përfaqëson të përdorën, ky është buxheti I përdoruesve të besimit të qytetarëve I përdoruesve të bandave të Elbasanit të cilat janë vetëm slogan mediatik për ta bërë Elbasanit në qytet I cili nuk mund të tërheqi dot investime, I cili mund të villet lehtësisht I cili sot nëser dhe për gjith jetën nëse do të vazhdojmë të sjellim kshu pacavuresh do të mbetet i tillë. ky buxhet nuk përfaqëson dot problematikën e fëmijëve të pobratit që nuk shkojnë dot në shkollë, as të rrugëve të lagjeve Skënderbej, as të banorëve të samurrit as të labinotit mal që kta zotërinjtë tonë që thonë kanë bërë rrugët shkoni ,kishtë rënë një autobus ka rrezikuar jetë fëmijësh labinot -katund labinot mal. Nuk përfaqëson dot as zonën tënde ti ky është buxhet që fut 250 milion lekë për pyje më një realizim plani që na sjell për 300 e ca milojn të vitit të kaluar që janë inekzistente ku janë kto 16 mijë pemë në gjinar, 17 mijë pemë në krastë ku janë? Investimë si ky që vete private të mbjelli pemë dhe kta I shkruajnë sikur I kanë mbllëjë kta. Ky është buxheti Elbasanit një buxhet I cili nuk shikon realitetin në sy, nuk shikon qytetarët që I merret taksë për infrastrukturën për parkimin dhe për të parkuar ne Elbasan duhet të cash gomat jo një herë por disa herë. Ky është buxheti I Elbasanit buxheti I nje njeriu që sot nuk përfaqson asnjë nga ato premtime që dha në fushatë ky është një buxhet elektoral po shpenzimet ,pagat ato që nuk mund të numurohen dhe të shikohen vidhen kollaj ky është buxheti I ASHPR, sepse ASHPU-ja nuk I përgjigjet më dhe ai e di mirë pse nuk përgjigjet, Ky është buxheti I atyre që kanë punuar kto përgjigjet sot zotërisë që është kryetar bashkie dhe nuk është buxheti më dhe I UKE-së po ka fime fantazëm në Elbasan që ka carë rrugët me të cilët ai zotrai ka pirë kafe jo unë. Ky buxhet nu përfaqëson qytetarët doni të miratoni buxhet e doni Elbasanin, Elbasanit jepini buxhet që ti sherbej qytetarëve, beni një punë që fëmijët të kalojnë në rrugë më asflat hiqni dorë nga gjelbërimi sepse e dimë shumë mirë që elbasani për pyje është vjedhur, jo sot por që kur ka qenë Taulant Balla e që ky zotrai ktu e shpalli armik, të lutem shumë dhe 5 minutëshin tim, e shpalli dikur armik dhe sot është në Pazar. Po ky nuk është buxheti I Elbasanit doni të miratoni buxhet Elbasani bëni rrugët që kanë kërkuar njerzit jo të atyre buxhetimeve që merrni jerëz të partisë por të atyre firmave që kam sjellë unë të atyre firmave që sjell cdo shqiptar ktu që I firmos me villnet të mirë nga halli që I qan në familje cdo natë jpo që I therret partia për të vajtur dhe për të votuar. sot keni



reflektura keni future tek tabela për samurrin në pikë të nëntë ke tabela që kishte ardhë pardje sot e keni nxjerr pikë të parë.samurri sështë me cakullim është më asflat për këtë u votua.Keni bërë një gabim ktu për fondin shqiptar të zhvillimit nga ato pika që do të conit tek fondi shqiptar I zhvillimit as 30% nuk do të vinë po erdhi 30 % pse nuk e ke futur Naim Frashërin sepse the vjet që Naim Frashëri do të futet tek skema e fondit shqiptar të zhvillimit mos më bëj me dorë ti e di mirë,I di mirë të gjitha kto që po them.Bëj një projekt buxhet,sot un jam kundra këtij buxheti qoftë se ka dëshirë nga mazjoranca të reflektojnë të fusi projekte për qytetarët të shtuhet për nesër sillni projekte që I shërbejnë qytetarëve dhe unë e votoj në të kundërt ky projekt buxhet nuk kalon moralisht,ktu ky krahu është I majtë në shërbim të qytetarëve jo në shërbim të xhepittë kryetarëve të atyre që janë bashkëorakëri me kontratë.Sot është mbledhja më e rëndësishme e viti nuk mund ti vjedhim qytetarët për herë të dytë ,unë e besova njëherë sot nuk e besoj më.Faleminderit.

### **Ermira Urupi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan**

Zoti lalaj,në përgjigje ndaj zotit Murataj meqënëse historikun e fjalimit të vetë për tu pompuar duke I numëruar me mirë se kush do tjetër ditët që kur duhet të përgatit për gjënë e madhe të vetën dhe unë ktu po I përgjigjem në këtë fjalim e fabulës së vet ti ai dora këmba lëvizja pyjet before London afer London më kupton shumë mirë zoti Murataj dhe pastaj si stoker që rri vet mund të numëroj pyje dete e çfarë të dojë vet I përegjigjem për pjesën politike dhe duke respektuar dicka familjare por e kërkon ktu fjala baba qeka familja por do ta lem pjesën e baballarëve të cilet ne I kemi premtuar që do të jemi sikurse I takon qytetarëve të Elbasanit,zoti Murataj në drejtimin politik nuk di ku I ka pas njerëzit e baballarët që të vi të flasi pastaj për status të mirfilltë të babait politik.dhe zoti Himci në respect të fjalës së tij të butë të qetë si një elbasanas,se ne ktu nuk vim për klithma I drejtohem duke I thenë si zotit Himci dhe kujdo tjetër kti klithma dalin nga ajo pjesë ef ma se nuk po duroj se shpirt dhe njerëz jemi dhe ne hidh baltë e hidh baltë.Ska më vend.

### **Imelda Sejdi-Anëtare e Këshillit Bshkiak Elbasan**

I nderuar kryetar të nderuar këshilltar besoj se ju e dëgjuat të gjithë kryetarin e Bashkisë që renditi të gjitha arritjet e buxheetit të vitit 2024 dhe I numëroj të gjitha investimet që janë bërë gjatë këtij viti dhe unë nuk e kuptoj se si mund të mohoet puna e një administrate e një bashkie dhe puna e këshillit sepse dhe ne jemi pjesë e kësaj pune që është bërë gjatë vitit 2024 dhe të thuhet që nuk është bërë asgjë dhe madje në 18 vitet e qeverisjes socialite të qytetit nuk është bërë asgjë.Jo më vonë se nëntori I vitit 2024 është publikuar një raport për performancën e Bashkisë për një periudhë 10 vjecare që nga momenti I fillimit të zbatimit të reformës së administrative

teritoriale nga viti 2014 deri në fund të vitit 2023 ku ka përfunduar dhe census I popullsisë dhe bashkia Elbasan është renditur si një nga Bashkitë me performancën më të mirë në të gjithë vëndin për disa tregues që janë ndarë në tre fusha: menaxhimi financiar, performance e shërbimeve dhe qeverisja burimet njerëzore dhe projektet. Autonomia fiskale e bashkive është e kufizuar, burimet e të ardhurave janë taksat, tarifat, dhe burime dytësore nga institucionet e varësisë dhe këto në një periudhë 10 vjeçare mesatarisht përbëjnë gati 40% të buxhetit të bashkisë ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga grantet nga transfertat e pakushtëzuar dhe nga transfertat civile por me këtë kufizim burimesh dhe me të gjitha burimet e tjera eficienta e shpenzimeve të bashkisë Elbasan gjatë këtyre viteve ka qenë 90% dhe në raport me eficientën në shkallë vendi është 20.5 më e lartë, pra nga 71% që është mesatarja në shkallë vendi bashkia Elbasan e ka 90% dhe me këto burime të kushtëzuara në dispozicion janë adresuar të gjitha prioritetet që kanë dalë nga buxhetimi me pjesëmarrje, që është një traditë tashmë e konsoliduar pranë bashkisë Elbasan prej shumë vitesh dhe është vlerësuar si një procedurë 100% transparente dhe bashkia paraqet projekte qoftë qeveris shqiptare qoftë donatorëve të huaj dhe për një periudhë 10 vjeçare ka përfituar 1.2 milion euro grant të cilat kanë shkuar për investime publike dhe për shërbimet e qytetarëve. Dhe për zonat rurale për sa i përket bujqësisë bashkia Elbasan ka shkallë më të lartë të kanaelave të kulluesve 77% në raport me 47% në shkallë vendi dhe shkallën e mirëmbajtjes më të lartë 73% në raport me 12% të mesatares në shkallë vendi. Nderko dhe pajisja me kanale ujëtare kemi një mesatare më të lartë sesa ajo e vendit nga 43% që e ka Elbasani në 23% në shkallë vendi. Është një nga bashkitë që ka numrim më të lartë të regjistrimit në kopshte dhe cerdhe publike në masën 73% në raport me 60%, kjo do të thotë që besimi i qytetarëve në shërbimet e bashkisë është i lartë. Dhe për sa i përket strehimit social që është diskutuar shumë në të gjitha mbledhjet bashkia Elbasan e ka shkallën e miratimit 99% në raport me 40% në shkallë vendi e gjitha kjo tregon që në Bashkinë Elbasan është bërë punë dhe buxhetet e bashkisë kanë qënë gjithmonë shumë të mira dhe shumë efektive, patjetër që ka vënd për të përmisuar e mira nuk ka fund bashkia do të vazhdojë të punojë ashtu si në buxhetin e vitit 2025 që i ka adresuar ato prioritetet që kanë dalë nga buxhetimi me pjesëmarrje më së miri jam e sigurt që do të vazhdojë dhe në vitet në vijim. Prandaj i ftoj të gjithë këshilltarët që ta votojnë buxhetin e vitit të ardhshëm. Faleminderit.

### **Altin Gjordumi-Anëtar I Këshillit Bashkia**

Përshëndetje kryetar dhe kolegë. Dua të flas disa fjalë për buxhetin e vitit 2025. Duke qënë se viti 2024 ka kaluar për ta mbyllur me sukses dua të shtoj dikë tjetër si përfaqësues i komunitetit mysliman, kam një kërkesë për buxhetin e vitit 2025.

Kërkojmë të miratohet një fond i dedikuar për festat e islamit. Këto festa dihet kush janë. Kërkoj që ky fond të jetë për evente, ndonjë panairë dhe të tilla që i përkasin kësaj feste. Dicka tjetër si banorë i Rajonit 2, më vjen mirë që kryetari përmendi disa gjëra si rehabilitimi i shesheve të pallateve. Ju faleminderit. Ftoj kolegët që këto që këkova ta miratojnë tek buxheti i 2025.

### **Lutfi Lala-Kryetar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Bashkia ta shikoj si kërkesë dhe ta miratojë nëse këshilltarët janë dakord. Do të rishikohet brenda muajit Janar.

### **Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Në rradhë të parë kërkoj ndjesë sepse unë nuk e kam natyrën që të flas me zë të lartë. Mbështes kërkesën e krahut të majtë dhe nëse ju mund ta shtrini në komunitete të tjera nëse keni para zbukurojmë qytetin për cdo besimtar. Kjo për pikën jemi dakord. Por nuk bie dakord me kërcënimin e këshilltares që ju jeni promotorët e zhvillimit. Në 20 vite që ju qeverisni qytetarët e Elbasanit nga arritjet e mëdha që ju bëni po ikin dita ditës, dhe e bukura është që dhe kur duan të vin për festa qytetarët i thon mos hajdeni se do hani pluhurin dhe gropat. Kjo për sa i përket sukseseve. Lerjani popullatës të votoj dhe të shikojmë se kush fiton. Përsa i përket buxhetit është ai i 2024 sic kërkova perqindje te investimet, dhe rialokimi i fondeve nuk i hyj dot se ku ka shkuar diferenca, ose është mosrealizim dhe ju nuk e thoni dhe shifrat ju nxjerrin zbuluar. Ju e keni futur tek transfertat e kushtëzuara që janë lëmoshat që jep qeveria sepse ne të qytetit të Elbasanit nuk u bëm njëher qytet që të konkurojme me qytetet si Korca e tj, ne nuk jemi vizionar. Shikoni të ardhurat që ishin vitin e kaluar, janë po të njëjtat që ishin vitin e kaluar dhe kjo bën që një njëri në Elbasan most ë kaloj më shumë se një ditë, dhe nëse rri nuk rri më shumë se disa orë, tek banjot publike që kemi vendosni një kartë sesa visitor se për cfarë vin. Për ta ilustruar ju miratuat 3 trafia, gjelbërim, pastrim dhe ndricim që nuk do sjellin të ardhura por ju ka rënë numri dhe pararësisht që i keni rritur me 25% këtu ajo që keni mbledhur në 2023 është 185 milionë, ajo që këni mbledhur në 2024 është 1 milionë më tepër. Duhet të ishte minimumi 10-12% rritje dhe pastaj kalojm që ndricimi nuk u përmirësua të paktën në lagjen time është i njëjtë, rrugët jo dhe aq por ketu dilni zbuluar. Përsa i përket si do zhvillohet qyteti, turizmi nuk zhvillohet vetëm sepse ju hidhni asfalt elektoral se kur shkon pas një muaji shikon se janë hapur gropat e para dhe është prishur. Jo më larg shkoni tek lagja 5 Maji keni hedhur asphalt një cip dhe keni

mbuluar dhe pusetat të cilat ishin dhe ujërat nuk kanë ku të ikin dhe qytetarët jua kanë sjell si ankesë. Ky është asfalti që ju keni bërë. Jemi tek mbështetja për zhvillim ekonomik 0 lekë, mbështja me grante për biznesin 0 lekë, promovimi i biznesit 0 lekë si do e zhvilloni? Nëse ju nuk jeni të parët që jepni dicka nuk të vjen njeri, nëse ti nuk ke një plan, po e coni elbasanin vetëm drejt votave. Kur nuk isha këshllitar nuk e kuptoja pse qyteti i Elbasanit ishte një këtë gjendje sot e kuptoj pse ky buxhet është mediokër, mund të ketë dicka të mirë por në përgjithsi është mediokër sepse mjafton të shikosh shifrat në paga jeni në realizim 100%. Do ta shikojmë në 11 Maj kur të vototjnë qytetarët.

### **Valbona Balliu-Anëtar I Këshill Bashkiak Elbasan**

Ju lutem dua informacion Muzeu Aleksandër Xhuvani jo që nuk ka mbaruar në kohë por as ka filluar. Në vitin 2024 është buxhetuar në vlerën 100 mijëljon lekë të vjetra. Përse muzeu nuk mbaroi kur nuk është vënë asnjë gurë, ku kanë shkuar këto lekë dhe vlera në 2025 e këtij muzeu tani i është shtuar 2 milion. Ky ose bëhet për të mbuluar diferencën prej 8 milojn lekësh që e keni futur këtu. E dyta rotondat, është parashikuar me 250 milojn dhe në 2024 janë shpenzuar 172 mijë lek është vënë ndonjë gur tek lulet gjatë 2024, jemi dëshmitarë është bërë ndonjë investim ku sipas shifrave na tregon që janë shpenzuar lekë. Ka një gjë që nuk shkon, më falni për ndjeshmërinë por këto janë para, rotonddat janë aty, a është bërë ndonjë investim? Kaq kisha.

### **Aulona Bylukbashi-Nënkryetare e Bashkisë Elbasan**

Mund ta sqaroj sepse është i rëndë konstatimi që u bë. Kam përshtypjen që keni një konfondim. Ke thënë një gjë që është e gabuar. Te dyja investimet kanë qënë investime të parashikuara në 2024 ka filluar procedura për rotondën është hedhur nuk ka pasur pjesëmarrë, është hedhur prap, ndërsa muzeu është në përfundim m eprocedurën. Fondi që i referohet është fondi buxhetor i vitit 2025 nuk është fond i harxhuar por kur të lidhet kontrata i kalojn buxhetit të vitit 2025. Nuk është harxhuar asnjë lek tek muzeu sepse nuk është lidhur kontrata akoma.

### **Doris Madhi-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Nuk besoj se ndonjëri këtu në sallë ka buzhetin e vitit 2024 por nëse do ta kishim në sallë dhe do të krahasoja zërat do shikonit të njëtën gjë. Përvec kësaj do shikoni një tranferim aparsh tek ASHPR, dhe unë nuk di që lagjja Haxhias apo Dyli Haxhire

janë pjesë e rurarel që ta di dhe unë dhe ti vë vetes time këtë rol. E dyta i keni dhënë mbi 313 milionë lek për pyllëzime dhe nga ky moment i keni transferuar pek ashpr përsëri, keni bërë në 2024 një prokurim që në vlerë lekësh ka rreth 19 milionë lek, ndërkohë te raporti na thoni se këto pemë janë mbledh nga donatorët. Keni planifikuar mbi 26 milojn për këto shërbime 7 milion ju mungojnë. Tjetër keni shpalluar nga 2024 gjatë Teorit prokurime për asetet e patundshme si rikonstruksionet e shkollave, na jepni si fond të trashëguar, pra këto lekët nuk janë të lira, ju sot keni 176 milion ju lutem na e bëni pak diferencën nuk po llogaris të gjithë ato blerja në vinca, fadroma, ku nuk po shkojmë dot në varreza, cfare korrni ju me këto makina? s ii planifikioni që të rikontruksioni ato rrugë që keni bërë në 2024. Ju ju takon apo kontraktorit? Kur tmë jepni ërgjigje se ku i keni cuar këto para mund të flisni për eficenc. Eficenca ka indikatorë, indikatorët kryesorë të eficencës dmth kthmi nga borxhi, kthimi nga investimet, kthimi nga asetet. Kur llogarisni këto dhe ta keni skemën e investimeve mbi 50 %. kur të shikoni se e keni kthimin nga borxhi më të madh sec e keni marrë dhe kur të shikoni se kthimin nga asetet e keni më të vogël e aq hajdeni flisni për eficenc. Tjetra keni miratuar 1470 punonjës, u rrit dhe fond ii pagës për secilin nga këto gjë që ne të opozitës e bëm me mirëkuptim, por cfarë shikoj sot që ju nuk na sillni një strukturë të detajuar cila është detyra e secilit, nëse nuk doni ma jepni X, Y Z ka këtë detyrë. Keni sektorë jo efictë, jeni qarë vet që ju është dashur shumë kohë të përgatisni materialin e buxhetit që nuk është përgatitur në mënyrë optimale, sepse nuk keni pasur staf, ku janë këto? Pse si është bërë realizimi nga ASHPU dhe ASHPR, si janë bërë riorganizimet e brednshme kë po mbroni. Ky fond pagash do vlente nëse vërtetë punonjësit do të punonin. Nëse ju vazhdoni e mbingarkoni me patronazhist por Elbasani si është sot do jetë akoma dhe në zi.

### **Lumturi Hasa-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Ju lutem kam një orë që mbaj dorën ngritur.

### **Lutfi Lala-Kryetar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Si ke një orë ti gjysmë ore ke që erdhe.

### **Lumturi Hasa-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Të shkojnë dhe ato njezëz që nuk i del, doja të thoja dikur ka qenë gur gur bëhet kalaja, tani stërvit stërvit na u prish dynjaja. Nuk do doja ti bënit shumë lavde.

Elbasani është bërë sikur ka rënë bombë, rruga e kalasë do kalojmë nga rruga të kalojmë tek Gurabardhi nuk kalon nga gropat. Most ë futemi në lagje, nuk do ishte mirë të miratohej vetëm me forcën e kartonit të përdorni trurin, edhe 8 muaj vijnë zgjedhjet dhe ato njerëz do ju votojnë. Aristoteli ka thënë se jo cdo gjë që shkruhet online është e vërtetë, kjo është tamam. Nuk më erdhi shumë mirë që nënkryetarja mos të ngërdheshet. Zonja Aulona do qeshin qytetarët në fund. Unë jam kundra këtij buxheti.

### **Ilirjan Sadiku: Anëtar I Këshillit Bashkika Elbasan**

Unë dua të falenderoj të gjithë stafin e bashkisë për këtë material voluminoz dhe nuk ka hapësirë për hamndësime. Ne d kërkujmë votoat do jen ato që vlerësojnë. Zotit Himci do i bëj një kërkesë që ta votj, unë i them që kur ta kenë ato mandatin unë do ta votoj.

### **Lutfi Lala-Kryetar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kush është pro

Këshilli Bashkiak me 27 vota pro, 8- kundër, - abstenim, miraton sa më sipër.

(V.K :E.Muzhaqi,B.Himci,L.Hasa,Y.Balliu.A.Mecja,A.Domi,M.Kaculi)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Shpresoj që ky material të realizohet sepse në fund të fundit është në interes ë të gjithë qytetarëve të Elbasanit.

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.12.2024, ora 10:20 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Kruetari I Bashkisë Elbasan Z.Gledian Llatja Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

#### **Pika e trembëdhjetë e rendit të ditës**

**13.Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.116,datë 30.11.2023 të këshillit Bashkiak,”për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan për vitin 2024”,të ndryshura me qëllim miratimi e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan për vitin 2025.**

### **Shefqet Bullari-Anëtar I këshillit Bashkiak Elbasan**

Në këtë projektvendim nuk kemi të bëjmë me asnjë ndryshim të taksave dhe tarifave, janë njëjloj si në vitin 2024, përvec disa rregulimeve të termave juridike që 35.1 është për bizneset me xhiro deri në 30 milojn lekë dhe disa ndryshime të termave që dhe në komision u miratua 100%.

### **Blendi Himci-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Se pari miratimi i tarifave në traditën e KB ka qënë në muajin Nëntor mbi bazën e të cilës përpikohet buxheti i bashkisë. Unë e kam me kryetarin sjelljin materialin me idenë që këtu kalojnë tarifat pas miratimit të buxhetit, të paktën si pikë të ishte vendosur para buxhetit, por nuk miratohet buxheti pa miratu taksat dhe tarifat sinqerisht unë e kuptoj që ju kei kartonin por nuk mund të abuzohet. Taksat të miratoheshin në Nëntor, sillet pas buxhetit që përpilohet mbi taksat. Faleminderit.

### **Lutfi Lala-Kryetar I Këshillit Bashkiak Elbasan**

Kush është pro



Këshilli Bashkiak me 27 vota pro, 6- kundër,- abstenim, miraton sa më sipër.

(V.K :B.Himci,L.Hasa,Y.Balliu.A.Mecja,A.Domi,M.Kaculi)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.12.2024, ora 10:20 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Kruetari I Bashkisë Elbasan Z.Gledian Llatja Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**


#### **Pika e katërbëdhjetë e rendit të ditës**

#### **14.Mbi kuotat financiare për ushqime për përfituesit e shërbimeve në Qendrën Sociale Balashe**

Këshilli Bashkiak me 33 vota pro, - kundër,- abstenim, miraton sa më sipër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.12.2024, ora 10:20 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Kruetari I Bashkisë Elbasan Z.Gledian Llatja Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

#### **Pika e pesëmbëdhjetë e rendit të ditës**

**15.Për ndryshimin e vendimit të Këshillit Bashkiak nr.26 datë 28.03.2024 të “Për miratimin e përdorimit të fondeve të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2024 të ndryshuar dhe shpërndarja e fondit ndërmjet 16 familjeve**

Këshilli Bashkiak me 26 vota pro, - kundër,- abstenim, miraton sa më sipër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.12.2024, ora 10:20 në ambjentet e qendrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Kruetari I Bashkisë Elbasan Z.Gledian Llatja Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

#### **Pika e gjashtëmbëshjetë e rendit të ditës**


**16.Mbi miratimin e riorganizimit të njësive operative vartëse të Bashkisë Elbasan dhe numrit maksimal të punonjësve të tyre dhe të aparatit të admknistatës së Bashkisë Elbasan**

Këshilli Bashkiak me 27 vota pro, - kundër,2- abstenim, miraton sa më sipër.

(V.A.V.Balliu,A.Mecja)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

## PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 26.12.2024, ora 10:20 në ambjentet e qëndrës rinore, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretar i Këshillit Bashkiak Elvi Çuni, Kruetari I Bashkisë Elbasan Z.Gledian Llatja Zv. Kryetare e bashkisë Znj. Aulona Bylykbashi, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

### **Lutfi Lala – kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan**

**Të ndryshme:**

**-Detajimi I shtesës së fondeve grand dhe korigjimi I planit të të ardhurave për vitin 2024**

Këshilli Bashkiak me 27 vota pro, - kundër,- abstenim, miraton sa më sipër.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

### **Bukurosh Stafa-Anëtar I Këshillit Bashkiak**

A ka mundësi ta rivotojmë atë pikën për dhënie në përdorim?

### **Aurora Domni-Anëtar I Këshillit Bashkiak**

Atë po presim.

### **Lutfi Lala-Kryetar I Këshillit Bashkiak**

Ajo do hidhet në process, nuk hidhet i ndarë nuk e kemi. E sjellim herën tjetër.

### **Aurora Domni-Anëtar I Këshillit Bashkiak**

Kam një kërkesë meqe kemi kaq lekë si bashki, propozoj drita dhe ujë falas për muajin e Krishlindjeve për shtresat në nevojë.

### **Iirjan Sadiku-Anëtar I këshillit Bashkiak**

Zoti kryetar një shpi e vjetër brënda kalasë ajo nuk ka pronar I ka në amerikë,të ngremë një komision ta vlerësojmë ose ta shëmbim ose ta rindertojmë se pse po kthehët në rrezik për qytetarët.